

INSTITUTI I POLITIKAVE MJEDISORE

Përpjekjet e Shqipërisë për të arritur kriteret mjedisore të BE-së dhe perceptimi publik

Si mungesa e vëmendjes mbi çështjet mjedisore mund të vonojë anëtarësimin e Shqipërisë në BE

Nga Edvin Pacara dhe Ilir Kalemaj

Përkthyer nga anglishtja: Endri Haxhiraj

Redaktuar nga Instituti i Politikave Mjedisore

Foto nga: Edvin Pacara

Me mbështetjen e



Botuar nga Instituti i Politikave Mjedisore, Tiranë, Shqipëri
me mbështetjen e Friedrich Ebert Stiftung Tirana

Tiranë, Nëntor 2010

© Autorët, Instituti i Politikave Mjedisore

Të gjitha të drejtat të rezervuara

Ky libër mund të porositet te:

Instituti i Politikave Mjedisore
Rruga Abdyl Frasheri
Ish Klinika Qeveritare, Shkalla 3, Kati 4
Tiranë, Shqipëri
Email: iep@iep-al.org
Telefon: + 355 682121765 (cell)



Përmbajtja

Përmbledhje e shkurtër.....	4
Përmbledhje Ekzekutive	5
Hyrje	6
Raste studimi në përballje me <i>acquis</i> mjedisore	7
Rasti i Bullgarisë	7
Ndihma e BE për Bullgarinë	8
Rasti i Rumanisë	9
Rasti i Shqipërisë.....	10
Përshkrimi i Problemit.....	10
Cilësia e ujit dhe e ajrit.....	11
Menaxhimi i Mbetjeve	13
Mbrojtja e Natyrës.....	13
Ndotja industriale dhe ajo kimike.....	14
Ndotja akustike.....	15
Ndryshimet Klimatike	15
Perceptimi i publikut për mjedisin.....	16
Metodologjia	17
Përgjigjet nga anketimi me grafikë.....	18
Komentet	33
Seminar (<i>workshop</i>)	36
Alternativat e Politikave	37
Përfundime dhe Rekomandime.....	39
Rekomandime praktike	40
Shtojca 1	41
Referencat	45



Përmbledhje e shkurtër

Ky libër i prezanton politikëbërësve dhe vendimmarrësve një studim mbi rëndësinë që luan përmbushja e kriterëve mjedisore për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian (BE).

Në këtë libër ne përpiqemi të analizojmë problemet kryesore në fushën mjedisore me të cilat përballet Shqipëria dhe perceptimin e këtyre problemeve nga publiku dhe media.

Në pjesën e parë, libri analizon rastin e Shqipërisë duke e krahasuar me problemet që kanë pasur Bullgaria dhe Rumania në fushën mjedisore përpara dhe pas hyrjes në BE dhe duke përshkruar rekomandime të vlefshme për Shqipërinë në mënyrë që të parandalohet procesi i kushtueshëm dhe i vështirë i anëtarësimit në BE që kaluan Bullgaria dhe Rumania.

Në pjesën e dytë, libri analizon gjendjen e mjedisit në Shqipëri, të analizuar sipas fushave kyçe nga Misioni i Komisionit Evropian në Progres Raportin për Shqipërinë, perceptimin e publikut mbi gjendjen e mjedisit në Shqipëri dhe prezantimin e saj në median shqiptare. Studimi përmbyllet duke ofruar një numër rekomandimesh politikash ndërkohë që analizon skenarët e mundshëm. Rekomandimet janë të bazuara në vlerësimet dhe analizat tona, por edhe nga praktikantët më të mira në vendet e BE.



Përmbledhje Ekzekutive

Acquis mjedisore janë pjesë e trupit legjislativ të BE-së i cili është i nevojshëm për tu integruar në sistemin e brendshëm ligjor të shteteve kandidate ose kandidate potenciale për anëtarësim në BE. Përveç integritit të trupit legjislativ të BE në sistemet e tyre të brendshme ligjore, shteti i cili aplikon për anëtarësimin e BE duhet të përshtatë dhe të përputhë zbatimin e kriterëve mjedisore të BE-së. Ky publikim fokusohet në një aspekt të statusit, për përmbushjen e kriterëve mjedisore të BE për Shqipërinë: perceptimi publik i implementimit të këtyre kriterëve e paraqitur kjo nga qytetarët dhe media. Ajo eksploron se si e shikojnë qytetarët implementimin e kriterëve mjedisore të BE-së, sipas fushës mjedisore të analizuar në Progres Raport i cili përgatitet çdo vit nga Misioni i Komisionit Evropian në Shqipëri.

Objektivat e studimit të perceptimit publik dhe të medias në përmbushjen e kriterëve të BE për mjedisin në Shqipëri janë vendimtare për të vlerësuar politikën e qeverisë në drejtim të integritit në BE dhe mospërputhjen mes kësaj të fundit dhe asaj çfarë publiku percepton – e njëjta mospërputhje zbatohet midis asaj që raporton media dhe asaj çfarë kupton publiku. Megjithatë pak të përfaqësuara në media dhe lajme, kriteret e mjedisit janë një prej pjesëve ligjore më të rëndësishme dhe strategjike që kanë nevojë të zbatohen po aq sa të përfshihen plotësisht në sistemin e brendshëm, për një anëtarësim të suksesshëm dhe efektiv në BE.

Aktualisht, presidenca Bullgare e cila mori postin në korrik 2010, theksoi pesë prioritet që duhet të kishte gjatë gjashtë-mujorit. Prioriteti i tretë i listuar ishte *acquis* mjedisor dhe fokusimi në reformat për të stimuluar ekonominë e gjelbër. Ky prioritet ishte po aq i rëndësishëm sa të tre (tashmë e njohur mirë) kriteret e Kopenhagen-it: politike (demokratizimi), ligjore (sundimi i ligjit) dhe ekonomike (aftësia e tregut për tu përballuar me konkurrencën e tregut me Komunitetin).

Perceptimi publik i sfidave më të mëdha në disa çështje si: problemet mjedisore, hyrja e legjislacionit për standardet mjedisore, kushtëzimi i BE në të tilla çështje dhe prioritetizimi i këtyre fushave përballë çështjeve të tjera janë matur nëpërmjet një sondazhi, rezultatet e të cilit do të reflektohen në këtë studim në mënyrë të rregullt. Një fokus të veçantë i është dhënë edhe monitorimit të medias, duke përfshirë pesë gazetën më të mëdha të përditshme në vend për një periudhë dy-mujore për të mësuar se çfarë hapësire dhe vëmendje i jep shtypi çështjeve mjedisore, veçanërisht në lidhje me integrimin në BE. Lajmet janë të organizuara në dy kategori: fakte/ raporte dhe analiza/ komente/ opinione, rezultati i të cilave do të ndihmojë në të kuptuarin e mëtejshëm të ndjeshmërisë së shoqërisë kundrejt axhendës mjedisore.

Ky studim i politikave (*policy paper*) trajton disa shqetësime të përgjithshme lidhur me çështjet mjedisore delikate, i referohet studimeve mjedisore bashkëkohore dhe gjithashtu ofron një dritare analitike dhe krahasimore duke marrë si shembull ballafaqimi rastin e Bullgarisë, një vend i cili ka arritur tashmë të anëtarësohet në Bashkimin Evropian.

Në fund janë shpalosur disa propozime, rekomandime dhe këshillime politikash me shpresën se do të reflektohen nga palët e interesuara që merren me aspektet ligjore dhe ekzekutive të legjislacionit mjedisor: përfshirja dhe zbatimi.



Hyrje

Gjendja e mjedisit dhe prirjet aktuale shfaqin një pengesë reale për anëtarësimin e Shqipërisë në BE në të ardhmen. Hyrja e Bullgarisë dhe Rumanisë në BE dhe problemet me të cilat u ballafaquan ato, me gjendjen e tyre mjedisore përpara dhe pas hyrjes, tregojnë një tendencë të krahasueshme edhe për Shqipërinë, për shkak të ngjashmërisë së problemeve dhe sfondit kulturor të shteteve që përmendëm më sipër. Procesi i minimizimit të degradimit të mjedisit të shkaktuar nga regjimi komunist dhe periudha e tranzicionit, sollën kosto të larta dhe të rënda të cilat u shfaqën edhe pas hyrjes së dy vendeve në BE. Sfida nuk konsistonte vetëm në përfshirjen e direktivave, rregulloreve dhe vendimeve të BE në legjislacionin kombëtar, por ishte në zbatimin tejet të kushtueshëm të këtyre ligjeve.

Shqipëria ka pasur një histori të ngjashme në situatën mjedisore. Ajo ka pika të nxehta të ndotura të shpërndara në mbarë vendin—një trashëgimi e regjimit komunist 45 vjeçar, nëpërmjet zhvillimit të industrisë së rëndë ndotëse e cila nuk i kushtoi vëmendje mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit. Një studim i kryer në Shqipëri nga UNDP, në Maj të vitit 2010, vuri në pah që ekzistojnë ende nëntë pika të nxehta në të gjithë Shqipërinë, të cilat kanë nevojë për ndërhyrje të menjëhershme.¹ Përveç dëmtimit të mjedisit të shkaktuar gjatë periudhës së komunizmit, mjedisi në Shqipëri ka vuajtur rëndë edhe gjatë 20 viteve të fundit, me një tendencë për degradim të mëtejshëm dhe me disa fusha mjedisore në përkeqësim të konsiderueshëm. Ndërkohë që Shqipëria ka aplikuar për anëtarësim dhe synon të jetë anëtar i BE-së në të ardhmen e afërt, ajo është duke mbetur prapa me kriteret mjedisore të cilat mund të jenë një barrierë serioze dhe e kushtueshme për përshpejtimin e procesit të anëtarësimit në BE në të ardhmen.

Ky libër tregon që sipas studimit të kryer nga Instituti i Politikave Mjedisore, publiku në Shqipëri është i vetëdijshëm dhe shumë i shqetësuar rreth gjendjes së mjedisit në Shqipëri, veçanërisht kur ai është i lidhur me integrimin e Shqipërisë në BE. Ndërkohë që publiku është i ndërgjegjësuar dhe kërkon më shumë veprim për frenuar këtë problem, perceptimi i pjesës më të madhe të publikut tregon se ai mendon që përmbushja e kriterëve mjedisore nuk është një shqetësim urgjent dhe madhor për axhendën politike Shqiptare. Nga ana tjetër media nuk e mbulon këtë problem në mënyrë të përshtatshme, sipas të dhënave të cilat ne do t'i shpalosim më tej në këtë libër. Sipas intervistave nga ky studim, media në Shqipëri nuk i kushton rëndësinë e duhur çështjeve mjedisore ashtu siç do të dëshironte publiku. Ky libër tregon që ka një mospërputhje midis asaj çfarë dëshiron publiku, asaj çfarë pretendon dhe synon politika Shqiptare dhe asaj çfarë shfaq media. Ky kombinim mbart rrezikun për dështim në zgjidhjen e problemeve mjedisore dhe në përparimin e procesit të integrimin në të ardhmen ose në skenarin më të mirë, të rezultojë në një barrë të papërballueshme ekonomike për Shqipërinë.

Qëllimi i këtij libri është t'i tregojë politikës dhe vendimmarrësve që mjedisi është një çështje kritike në procesin e hyrjes së Shqipërisë në BE, që mjedisi është një çështje shqetësuese madhore për publikun Shqiptar dhe gjithashtu për t'i treguar medias shqiptare se ajo çfarë ato pasqyrojnë (ose mungesa e pasqyrimin) në fushën e mjedisit lidhur me integrimin në BE, nuk përputhet me atë çfarë dëshiron publiku. Ne duhet të jemi të vetëdijshëm se një studim i vetëm nuk mund të adresojë çdo aspekt të problemit të politikave që shqetësojnë mjedisin në Shqipëri në sfondin e anëtarësimit në BE dhe mund të ekzistojnë kufizime lidhur me cilësinë dhe tipin e të dhënave të mbledhura për studimin.

¹ UNDP Albania, *Vlerësimi i nëntë pikave prioritare në Shqipëri dhe përgatitja e planit të veprimit të rehabilitimit*: <http://www.undp.org.al/index.php?page=detail&id=138>



Raste studimi në përballje me *acquis* mjedisore

Rasti i Bullgarisë

Rasti i Bullgarisë është një prej rasteve më të rëndësishme për shkak të ballafaqimit me disa pengesa për të hyrë në BE, ekzaktësisht prej etapave mjedisore. Më specifikisht, Bullgarisë iu desh të mbyllte dy reaktorët nuklear në Kozylin në mënyrë që të merrte dritën e gjelbër nga BE-ja në rrugën e integritit. Kjo nuk erdhi me kosto të vogël për Bullgarinë, e cila mbështeste një kuotë të rëndësishme të eksporteve të saj në këto dy impiante nukleare. Gjithsesi, kriteret e mbrojtjes së mjedisit të BE-së provuan se morën vendin kryesor të axhendës së politikëbërësve në vend dhe në fund ata morën vendimin në pajtim të plotë me kushtet e BE-së.

Rruga e Bullgarisë për përmbushjen e *acquis* mjedisore ka vazhduar edhe pas arritjes formale të kriterëve për anëtarësimin në BE. Për shkak të interesave gjeostrategjik, gjeopolitikë dhe ekonomikë, qeveria e mëparshme Socialiste e Bullgarisë kishte nënshkruar dy marrëveshje të veçuara me Federatën Ruse për ndërtimin e reaktorëve të rinj (nuklearë), sikurse të qënit e një prej vendeve pjesmarrëse në tubacionin naftësjiellës të Burgas-Aleksandroupos, të dyja me ndikim të theksuar mbi mjedisin, gjë që përfaqësonte edhe një kërcënim për vendet e tjera të BE-së. Pas presionit nga këto të fundit, kryeministri i ri Bullgar, Mr. Borizov, vendosi për të hequr qafe dy marrëveshjet bilaterale dhe kërkoi referendum kombëtar për të mbështetur vendimin e tij.

Bullgaria pati që në fillim një nisje të paqëndrueshme në standardet e saj mjedisore dhe mungesë të reformave të përshtatshme për t'i adresuar ato në mënyrën e duhur. Deri në vitin 1996, një studim i OECD në Bullgari vuri re ndër të tjera që:

“nuk është ndjekur zbatimi i politikave mjedisore dhe investimeve për përmirësimin e mjedisit. Zhvillimi e sistemit rregullator është shtyrë nga një proces legjislativ i ngadaltë. Shfrytëzimi i burimeve nga sipërmarrjet, qeveria dhe ekonomitë shtëpiake ka provuar në pikëpamjen e detyrimeve ekonomike duket e vështirë. Pesha e ndotjes së ajrit dhe ujit është reduktuar por kryesisht për shkak të uljes së prodhimit; një vazhdim i rritjes ekonomike mund të rritë presionin mbi mjedisin”²

Nga ana tjetër, opinioni i KE-së mbi Bullgarinë të vitit 1997 konstaton se: “Cilësia e ajrit lokal pozon një rrezik të rëndësishëm për shëndetin njerëzor. Mbetjet janë një fushë madhore shqetësimi: praktikrat e menaxhimit të mbetjeve janë elementare, veçanërisht për mungesën e sistemit të depozitimit, dhe djegia e tyre nuk rregullohet me ligje. Ndotja e tokës dhe erozioni gjithashtu janë serioze.”³

Në vitin 1997, Komisioni Europian vlerësoi një kosto financiare totale prej 15 bilion € për implementimin e *acquis* mjedisore në Bullgari, një çmim i reduktuar në 8.6 bilion € në vitin 2001.⁴ Kështu, siç tregon qartë shembulli Bullgar, kushtëzimi i *acquis* mjedisor, ose kërbaci i BE-së duhet të shoqërohet me kulaçin e integritit, veçanërisht në formën e ndihmës financiare për të mundësuar që të arrihen në kohë e duhur. Kostoja e vlerësuar nga 8.6 në 15 bilion € për reformat mjedisore për përshtatjen me legjislacionin e BE-së për mjedisin janë afërsisht vlera e përgjithshme e rritjes vjetore të

² OECD, *Environmental Performance Reviews – Bulgaria*, OECD, 1996, konkluzione dhe rekomandime.

³ EC, *Commission Opinion on Bulgaria's Application for Membership of the European Union*, 15 Korrik 1997, fq. 94.

⁴ EC, *Communication from the Commission: The Challenge of Environmental Financing in the Candidate Countries*, 2001, quoted in: ECOTEC, *The benefits of compliance with the environmental acquis for the candidate countries*, Korrik 2001, fq. 15.



PBB-së së një vendi të madhësisë së Shqipërisë. Në vitin 1997, Bullgaria kishte shpenzuar vetëm 4.5 milion € mbi mjedisin. Nëpërmjet krahasimit mund të nxjerrim konkluzionet dhe rekomandimet e nevojshme. Këtu duhet të theksojmë se sa e rëndësishme është përputhja e plotë e trupit tonë ligjor me *acquis communautaire*, sidomos për rritjen e vëmendjes ndaj mjedisit, nevojën që projektet e administratës të jenë të konkurrueshme dhe me standardeve të larta për të qenë në gjendje të nxjerrin fonde dhe financim nga BE. Kjo është një kusht thelbësor (*sine qua non*) për implementimin sikurse për rritjen e kalimit formal të legjislacionit mjedisor.

Ndihma e BE për Bullgarinë

BE-ja ofroi ndihmë të rëndësishme për Bullgarinë. Ndër të tjera, ajo siguroi udhëzime të shumta për nevojën e ndryshimit të legjislacionit Bullgar për të përmbushur standardet e BE-së dhe në llojet e institucioneve të nevojshme për realizimin e saj. Në një ushtrim të quajtur “*screening*” (ang: shqyrtim, ekzaminim), KE-ja dhe ekspertë bullgarë shqyrtuan legjislacionin mjedisor dhe institucionet Bullgare duke analizuar ato që ishin apo nuk ishin në përputhje me legjislacionin e BE-së. Kjo ndodhi për herë të parë në vitet 1998-1999 pasi Bullgaria u bë një shtet kandidat dhe u përsërit në prag ta hapjes së bisedimeve mbi kapitullin e mjedisit (në 27 Korrik 2001). Ushtrimi ishte një radiografi e situatës në Bullgari dhe tregoi atë që pritej nga BE-ja për të ndryshuar në këtë fushë.⁵

Gjithashtu BE-ja ofroi ndihmë teknike për të ndihmuar në ngritjen e kapaciteteve institucionale të nevojshme. Një total prej 22 projektesh (ose nën projektesh) u zbatuan midis viteve 1998 dhe 2005, duke filluar me mbështetjen e përgjithshme (zhvillimin e strategjive, planeve, transpozimin e legjislacionit) dhe në forcimin e pjesëve të veçanta të administratës për zbatimin e direktivave specifike dhe në trajnimin e zyrtarëve në nivele rajonale dhe lokale. Gjatë gjithë periudhës shtatë vjeçare nga viti 2000 deri në vitin 2006, BE-ja investoi në sektorin mjedisor më shumë se të gjithë institucionet bullgare vënë bashkë –22 projekte mjedisore me një vlerë totale 643 milion € u pranuan nga Komisioni.⁶ Gjithçka dukej në vendin e duhur për anëtarësimin e Bullgarisë në 1 Janar të vitit 2007, me ligjet e transpozuar dhe projektet që shkonin mirë. Qeveria Bullgare ishte e emocionuar për përparimin që vendi kishte bërë në fushën mjedisore. Por vështirësitë e kthimit të sistemit kaq shpejtë, u shfaqën vetëm dy vjet pas anëtarësimit të Bullgarisë në BE me gjithë ndihmën e madhe dhe të vazhdueshme teknike dhe financiare. Në Tetor të vitit 2009, Komisioni Evropian i dërgoi vërejtje me shkrim Bullgarisë për katër raste të veçanta të dështimit lidhur me sigurimin e mbrojtjes së përshtatshme për trashëgiminë e saj natyrore. Tre nga paralajmërimet lidheshin me zonat e mbrojtura, ndërsa shqetësimi i katërt kishte të bënte me legjislacionin në vend, lidhur me dështimin për ta sjellë legjislacionin mjedisor Bullgar në përputhje të plotë me kërkesat Evropiane.⁷

Komisioni Evropian kishte nisur një procedurë për shkelje në ligjin e mbetjeve nga Bullgaria, që prej anëtarësimit së saj më 1 Janar 2007.⁸ Pasi Bullgaria dështoi për të zgjidhur shkeljen e procedurës, në lidhje me asgjësimin jo të përshtatshëm të mbeturinave në kryeqytetin e saj, Sofje, i cili duhet të kishte pasur një rrjet të përshtatshëm instalimesh në vend për deponimin e mbetjeve që prej kohës së pranimit të saj në 1 Janar 2007, Komisioni Evropian filloi procedurën gjyqësore kundër Bullgarisë për dështimin

⁵ *Bulgaria's quest to meet the Environmental acquis. ESI Background paper*, 10 Dhjetor 2008, fq.3.

⁶ Nga i njëjti burim, fq.4

⁷ Bullgaria merr 4 paralajmërimet të veçanta për shkak të dështimit lidhur me përshtatjen e legjislacionit për mbrojtjen e natyrës: <http://europa.eu/rapid/pressReleasesAction.do?reference=IP/09/1484>

⁸ Komisioni Evropian hedh në gjyq Bullgarinë lidhur me Menaxhimin e Dobët të Mbetjeve: http://www.novinite.com/view_news.php?id=110221



e zbatimit të përshtatshëm të legjislacionit Evropian për mbetjet. Financimi i Komunitetit ishte në dispozicion të Bullgarisë për të përmirësuar infrastrukturën e mbetjeve në kryeqytet.⁹ Ky ishte gjyqi i parë i nisur nga Komisioni Evropian kundër anëtarit të ri të BE-së.

Këto raste tregojnë se edhe pse Bullgaria bëri shumë përpjekje për të arritur kriteret e BE-së për mjedisin dhe ndihma financiare e dhënë nga BE-ja ishte e madhe, ekzistonin ende disa të meta të cilat u shfaqën pas pranimit. Një pengesë dhe vështirësi të ngjashme mund të haset nga Shqipëria, veçanërisht duke pasur parasysh pozicionin më të vështirë fillestar që ka vendi dhe prirjet drejt degradimit të mëtejshëm të mjedisit që është vënë re gjatë viteve të fundit. Procesi mund të përkeqësohet nga kriza financiare e BE-së dhe nga pakësimi i vullnetit për të financuar shtetet e reja që anëtarësohen në BE. Shqipëria mund të nxjerrë mësim të vlefshme nga përvoja Bullgare dhe të investojë më shumë në parandalimin e burimit të problemeve dhe jo duke u përpjekur për të zbutur problemet e kushtueshme mjedisore të akumuluar prej vitesh degradimi dhe neglizhence ndaj mjedisit.

Rasti i Rumanisë

Përpara hyrjes në BE, Rumania në një mënyrë të ngjashme me Bullgarinë edhe pse me më pak entuziazëm, u përball me pengesa të mëdha mjedisore në përputhje me standardet mjedisore të BE-së. Kjo rezultoi kryesisht për shkak të mungesës së investimeve në infrastrukturën mjedisore dhe vëmendjes së kufizuar të dhënë nga qeveria dhe agjencitë shtetërore ndaj këtyre çështjeve të ndjeshme, siç ishin ato të lidhura me mjedisin. Sipas Qendrës Kombëtare për Statistikat dhe burime të tjera, shpenzimet totale vjetore për mjedisin mbetën konstante në rreth 0.6 përqind të GDP-së midis viteve 1993 dhe 1996. Në vitin 1996, investimet e përgjithshme mjedisore arritën në më shumë se 200 milion dollarë. Megjithatë, shumica e investimeve mjedisore në Rumani ishte shumë e ulët në krahasim me nivelin e BE-së dhe situata u përkeqësua nga mungesa e instrumenteve ekonomike. Ajo që duhet vënë në dukje ishte se Rumania kishte nevojë për investime masive në mjedis si nga qeveria edhe nga industrisë në përputhje me standardet e BE-së.¹⁰

Përqindja e GDP-së që u përkushtua mjedisit në gjithë këto vite ishte nën 1 përqind. Mungesa e investimeve të tilla dhe vëmendjes nga qeveria rumune, pa dyshim kishte koston e vet në standardet dhe cilësinë e mjedisit. Vetëm në vitin 1994 dhe 1995, ajo u rrit në 2.7 përqind të buxhetit të shtetit. Suksesi i vetëm i qeverisë rumune në përputhje me standardet mjedisore të vendeve të BE-së ishte “Fondi i Ujit” (‘Water Fund’) i cili ishte përdorur kryesisht për të financuar investimet në trajtimin e ujërave të zeza, pajisjeve për kontrollin e shkarkimeve dhe investime të tjera të lidhura me ujin dhe ujërat e zeza. Megjithatë, siç tregon edhe raporti i REC “ky fond nuk ofron burime të mjaftueshme financiare për të financuar projektet më urgjente të lidhura me ujin.”¹¹

Një strategji afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë ndihmoi Rumaninë të ndiqte rrugën e duhur në përmbushjen e kriterëve mjedisore. Disa nga masat e planifikuara ishin si vijon:¹²

⁹ Komisioni çon në gjyq Bullgarinë për vonesën e sigurimit të mjedisve të përshtatshme të mbetjeve për Sofien:

<http://europa.eu/rapid/pressReleasesAction.do?reference=IP/09/1788&format=HTML>

¹⁰ <http://archive.rec.org/REC/Publications/EmEnvMarket2/Romania3.html>

¹¹ *Nga i njëjti burim*

¹² *Nga i njëjti burim*



Objektivat afatshkurtra (para vitit 2000):

- reduktim me 20-30 përqind i emisioneve në 14 “pikat e nxehta”
- reduktim i dioksidit të squfurit dhe azotit me 20 përqind dhe të klorit dhe H₂Cl me 40 përqind
- ripërdorim i mbeturinave të mbledhura nga gazet dhe ujërat e përdorur me 10-15 përqind
- rritje të ripërdorimit të mbetjeve të ngurta me 20 përqind
- rehabilitim të tokës me kapacitet të reduktuar për depozitim të mbetjeve të ngurta
- kontrolli i hedhjes së mbetjeve komunale
- ujitje të 1.5 milion hektarëve dhe mbjellja e 50,000 hektarëve me rripa pyjorë
- luftim i erozionit të tokës në 1.5 milionë hektarët e përdorur për bujqësi
- rritje e sipërfaqes së pyjeve me 200,000 hektarë

Objektiva afat-mesme (para vitit 2005):

- ulja me 50 përqind e mungesës së ujit ekzistues
- përmirësim të cilësisë së ujërave sipërfaqësorë duke rritur gjatësinë e lumenjve të kategorisë së parë në 60-65 përqind të totalit dhe reduktimi i lumenjve të degraduar (kategoria D) në 10-15 përqind të totalit
- pakësim të ndotjes së ajrit nga 20-30 përqind e nivelet e vitit 1989 për SO₂, CO, NH₃, CH₄
- reduktim të ndotjes nga metalet e rënda me 80 përqind
- zero shkarkime të gazeve serë që ndikojnë në shtresën e ozonit (nga 2008 për disa gaze)
- rritje e sipërfaqes pyjore me 30 përqind
- rehabilitimi i Deltës së Danubit me 70-80 përqind

Objektivat afat-gjata (përpara vitit 2025)

- arritja e kushteve të jetesës të përputhshme me standardet e vendeve të përparuara
- reduktim të ndotjes në një nivel të pranueshëm në përputhje me standardet e BE-së
- përputhja me konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare¹³

Rasti i Shqipërisë

Përshkrimi i Problemit

Degradimi mjedisor në Shqipëri nuk është diçka që mund të merret lehtë ose edhe më keq, të mos vihet re sikundër ka ndodhur shpesh në periudhën e tranzicionit paskomunist. Ndërsa kemi me dhjetra *hotspot*-e të dokumentuara apo të padokumentuara, të trashëguara nga sistemi komunist, kemi me dhjetëra *hotspot*-e apo probleme të tjera mjedisore të krijuara nga industritë ndotëse këto njëzet vitet e fundit. Megjithëse janë vërë re disa përmirësime në *landfill*-et dhe trajtimin e ujërave të ndotura, progresi ka qenë përgjithësisht minimal dhe në disa vende është vënë re regres, duke vendosur bazat për

¹³ Nga i njëjti burim



një trend të rrezikshëm për mjedisin dhe arritjen e kriterëve mjedisore të BE-së. Shkatërrimi i parqeve natyrore, ndotja e ujërave të lumenjve dhe deteve, ndotja e tokës, zhdukja e pyjeve dhe zhdukja e shpejtë e biodiversitetit dhe ekosistemeve mund të jetë e pakthyeshme nëse vazhdon me ritmin aktual dhe mund të rezultojë në një rrezik serioz për jetën e popullsisë në terma afatgjatë dhe një pengesë në integrimin e suksesshme të Shqipërisë në BE.

Politikat mjedisore të BE-së, synojnë të promovojnë zhvillimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen e mjedisit për gjeneratat e tanishme dhe të ardhshme, duke u përpjekur për të parandaluar më tepër sesa të luftojë zbutjen e kushtueshme të rezultateve të ndotjes dhe degradimit të mjedisit. Këto politika janë të bazuara në integrimin e mbrojtjes së mjedisit në politikat e tjera të BE-së, aksion parandalues, dhe në parimin që ndotësi paguan, duke luftuar dëmin mjedisor në burim dhe duke ndare përgjegjësitë.¹⁴ *Acquis* përmban mbi 200 akte ligjore që mbulojnë legjislacionin horizontal, cilësinë e ujit dhe të ajrit, menaxhimin e mbetjeve, mbrojtjen e natyrës, ndotjen industriale dhe menaxhimin e riskut, dhe kimikatet e zhurmat. Garantimi i zbatimit të *acquis* kërkon investime të rëndësishme por edhe sjell përfitime të rëndësishme.

Thjesht transpozimi i bazës ligjore të BE-së nuk është e mjaftueshme për të arritur kriteret mjedisore për integrimin e Shqipërisë në BE. Një administratë kompetente dhe e pajisur mirë duhet të jetë funksionale nëse duam që zbatojmë me sukses këto ligje. Administrata publike duhet të ketë burime financiare, njerëzore dhe legale për të ndërhyrë në zbatimin e ligjit. Sikundër Misioni i Komisionit Evropian në Shqipëri ka vënë re: “përgjithësisht, niveli i zbatimit dhe imponimit të ligjeve është i ulët si pasojë e ligjeve të dobëta, mungesës së burimeve njerëzore dhe financiare, mungesës së ndërgjegjësimit në qeveri, përgjegjësi të fragmentarizuara dhe një sistemi gjyqësor të dobët.”

Megjithëse duket se janë arritur disa suksese në transpozimin e legjislacionit vertikal të BE-së, legjislacioni horizontal është i lidhur mjaft dobët me *acquis* dhe nevojiten përpjekje të mëdha për të finalizuar procesin.

Nuk ka vullnet politik për të zbatuar legjislacionin mjedisor të ri të futur në fuqi, gjë që është përdorur nga popullata në përgjithësi, si dhe bizneset, shqiptare dhe të huaja, për të thyer këto rregulla dhe për të shfrytëzuar ekosistemet dhe burimet natyrore, duke i sjellë ato në piken e moskthimit mbrapa ku dëmi bëhet i pakthyeshëm.

Disa fusha kyçe të trajtuara janë fushat të cilat BE-ja i analizon çdo vit në kuadër të integritimit të Shqipërisë në BE, të cilat janë si vijon:

Cilësia e ujit dhe e ajrit

Megjithëse ka njëfarë progresi në fushën e trajtimit të ujërave të ndotura dhe menaxhimin e landfilleve, ky progres ka qenë i ngadaltë dhe kostoja e zgjidhjes së ndotjes në fund dhe jo në burim, ka qenë tepër e madhe. Disa nga arritjet kryesore janë ndërtimi i impiantit të ujërave të zeza në Pogradec dhe një impiant i thjeshtë i trajtimit të ujërave të zeza në Sarandë që kushtojnë respektivisht 13.5 milionë euro dhe 4 milionë euro. Granti i dhënë për impiantin e Pogradecit ka qenë një donacion i qeverisë gjermane ndërsa për Sarandën është bashkëfinancuar nga institucione të ndryshme ndërkombëtare dhe qeveria e Luksemburgut. Sikundër shihet nga këto raste të suksesshme, ato ishin shumë të kushtueshme, fondet ishin donacione të qeverive të huaja dhe këto kanë zgjidhur problemin vetëm për dy qytete të vogla,

¹⁴Commission Opinion on Albania 's application for membership of the European Union



përsëri duke mos e kapur problemin në burim por në pasojë. Gjithsesi kjo është në linjë me direktivat përkatëse të BE-së.

Studimet të kryera nga shteti apo institucione të pavarura dhe nga OJF, kanë treguar se pjesa më e madhe e përrrenjve dhe lumenjve në Ultësirën Perëndimore janë **shumë ose jashtëzakonisht të ndotur** me të paktën pesë lumenj që nuk mund të quhen më lumenj, por kanale ujërash të zeza të hapura. Vetëm Tirana, ka dy nga pesë lumenjtë më të ndotur në shkallë vendi, lumin e Lanës dhe lumin e Tiranës, me shifra ndotjeje në çdo aspekt, me dhjetëra herë mbi shkallën maksimale të lejuar, krahasuar kjo me kufijtë e ndotjes dhe direktivat e BE-së për cilësinë e ujërave.

Zbatimi i Direktivës së Nitratit dhe kërkesat që specifikon për ndotjen nga burimet bujqësore është një nga më komplekset në atë listë dhe Shqipëria ka një rrugë të gjatë përpara për zbatimin e asaj direktive. Aktualisht, nuk ka një zbatim të reduktimit të ushqyesve në Shqipëri, një proces që kërkon shumë fonde. Shumë vende candidate kanë kërkuar në fakt, një periudhe tranzicioni për zbatimin e kësaj direktive para anëtarësimit në BE, që mund të jetë dhe rasti i Shqipërisë në të ardhmen.

Një temë tjetër e nxehtë përsa i përket cilësisë së ujërave ka qenë ndotja e deteve, lumenjve dhe liqeneve me mbetje të ngurta, të cilat janë të dukshme dhe frenon zhvillimin e turizmit. Kjo është ndotja me e dukshme dhe me e debatuar si në media, ashtu dhe në publik, dhe gjithashtu ku ka pasur ndërhyrje herë pas here nga qeveria, ndonëse sporadike dhe me rezultate afatshkurtra, si p.sh. prishja e tubacioneve të ujërave të zeza që derdheshin në detin Adriatik—por pa një masterplan apo strategji se si të trajtoje dhe zgjidhe këtë problem në burim ose ta parandalojë atë.

pa një strategji kombëtare apo plan të përgjithshëm në lidhje me këtë pikë.

Menaxhimi i mbetjeve është pjesa më e dukshme e problemeve mjedisore në Shqipëri dhe për rrjedhojë pjesa më e debatuar për shkak të dukshmërisë së saj. Gjithashtu lidhet me cilësinë e përgjithshme të ujërave, dhe siç e pamë në rastin e Bullgarisë, mund të jetë një nga shkaqet e frenimit të integritetit të Shqipërisë në BE ose një burim vendosjesh së gjobave apo hedhjes në gjyq nga ana e Komisionit Evropian në rast se Shqipëria arrin të anëtarësohet në BE në të ardhmen. Lumenjtë kanë shërbyer si vend grumbullimi mbeturinash për së paku 20 vitet e fundit, duke i transformuar ato në kanale ujërash të zeza të hapura të cilat transportojnë mbeturina në detet Adriatik dhe Jon. Kjo është një thyerje e qartë e normave komunitare dhe direktivave të BE-së, me pikën kulminante kur mbeturinat nga Shqipëria dolën në brigjet e Kroacisë, duke i hapur rrugën një çështje gjyqësore mes Kroacisë e Shqipërisë.

Nuk ka studime apo raporte mbi ndotjen apo zbrazjen e burimeve të ujërave nëntokësore, por mendohet se ka shqetësime serioze në këtë fushe veçanërisht në zbrazjen dhe kripëzimin e këtyre burimeve si pasojë e marrjes masive të ujit nga këto burime dhe betonizimi i zonave të mëdha, gjë që ka penguar ujin e shiut të depërtojë në tokë.

Cilësia e ajrit është një nga problemet e tjera të rënda mjedisore të Shqipërisë. Tirana është konsideruar si një nga kryeqytetet më të ndotura të Evropës dhe të botës për cilësinë e ajrit. Nuk ka ndonjë plan apo strategji për ta luftuar këtë ndotje përveç disa strategjive vendore të cilat mund të japin rezultate të kufizuara nëse nuk janë të koordinuara me njëra-tjetrën. Qendrat kryesore urbane në vend, Shkodra, Durrësi, Tirana, Fieri, Korça dhe Vlora kanë qendra monitoruese për ndotjen të cilat tregojnë të dhëna të frikshme për cilësinë e ajrit. Të gjashtë qytetet kanë ndotje ajri që i kalon 3-fish nivelin maksimal të lejuar nga BE-ja, me një nga këto pika matjeje në Tiranë që shenon ndotje që kalon 6 herë nivelin maksimal të lejuar nga BE. Me pak fjalë, ajri në Tiranë mund të jetë helmues dhe i rrezikshëm për shëndetin. Vetëm në qytete të vogla, të cilat janë në zona kodrinore apo malore, ajri është i një cilësie të mirë si pasojë e mungesës së trafikut dhe industrisë.



Bashkitë (veçanërisht Tirana) në Shqipëri kanë filluar mbjelljen e pemëve për zbutjen e ndotjes së ajrit por rezultatet janë të kufizuara për shkak të sipërfaqes së kufizuar për mbjellje dhe planifikimit të keq (apo të munguar) urban. Bashkia Tiranë ka filluar nisma si korsitë e ndara për autobusët dhe biçikletat, megjithëse me sukses të kufizuar për shkak të trafikut kaotik si pasojë e mungesës së imponimit të rregullores së qarkullimit dhe mungesës së traditës nga ana e publikut se si të sillen në trafik. Shkak kryesor i ndotjes mbetet cilësia e naftës (kryesisht diesel) e cila lejohet të hyjë në tregun shqiptar, dhe cilësia e makinave që qarkullojnë në rrugët e Shqipërisë. Mungesa e zbatimit të rregulloreve të ndërtimit, kontribuon në rritjen e PPM 10 në qendrat kryesore urbane. Instituti i Shëndetit Publik pranon se cilësia e keqe e ajrit e shkurton mesatarisht 2 vjet jetën e çdo banori të Tiranës por dëshmi anekdotike nga doktorë apo ekspertë në Tiranë, tregojnë se ky nivel ndotjeje shume mirë mund të shkurtojë jetën e çdo qytetari me 10-12 vjet. Një krahasim i cilësisë së ajrit të Tiranës me studimet kryesore që gjetën se ndotja e ajrit shkurton jetën të kryera në Uashington dhe Londër, ripohojnë këto pretendime. Një ndotje mjaft e rëndë shkaktohet edhe nga gazra helmues të emetuara nga industria e naftës në Ballsh ku ajri është teknikisht i pathithshëm dhe helmues për mushkëritë.

Menaxhimi i Mbetjeve

Një progres i vogël është bërë me rehabilitimin e landfilleve, veçanërisht me Sharrën. Por ende mungon një plan apo strategji kombëtare për menaxhimin e mbetjeve dhe secila bashki apo komunë ka metodën e vet të grumbullimit e cila konsiston kryesisht në mbledhjen primitive të mbetjeve nga kazanët dhe më pas depozitimin e thjeshtë në landfille. Hedhja e mbetjeve në thujse çdo fshat shqiptar bëhet duke i depozituar ato buzë rruge, në lumenj apo liqene apo duke i hedhur mes pyjesh e fushash, ku zakonisht ato digjen duke përkeqësuar më tej ndotjen e ajrit. Riciklimi bëhet kryesisht nga kompani private, të cilat zakonisht pranojnë mbetje metali, plastike apo letre. Nuk ka ende të dhëna sesa nga këto mbetje shkojnë te kompanitë e riciklimit, për shkak të mbledhjes së tyre në një pjesë dërrmuese nga romët apo të varfrit e tjerë.

Megjithatë, për shumë turistë, mbetjet e depozituara thujse gjithandej në territorin e Shqipërisë, është bërë shkak që disa prej tyre të zgjedhin për mos t'u rikthyer më për pushime; në shumë blogje interneti ku flitet për Shqipërinë, mund të shohësh frazën “gjeja e parë që sheh kur i afrosh një qyteti në Shqipëri janë qeset plastike dhe grumbujt e mbeturinave anash rrugëve..” Ka një mungesë të plotë kulture të hedhjes së mbeturinave dhe është e zakonshme të shihen qytetarë që i hedhin ato në lumin e Lanës që përshkon Tiranën tejprtej.

Menaxhimi i mbetjeve mund të jetë një problem real që mund të ndalojë dhe vonojë integrimin e Shqipërisë në BE, ose mund të jetë një shkak për gjyq nga ana e Komisionit Evropian ndaj Shqipërisë në rast se kemi një integrim të vendit në BE.

Mbrojtja e Natyrës

Vetëm 12 përqind e territorit në Shqipëri ka zyrtarisht një status si zonë e mbrojtur. Ky mbulim kombëtar me zona të mbrojtura është shumë i vogël për të pasur një ndikim afatgjatë në mbrojtjen e biodiversitetit.¹⁵ Duke marrë në konsideratë shifrat e BE-së ku 18 përqind e territorit të shteteve anëtare

¹⁵ See for more: CLOSING THE GAP Assessing and Improving Environmental Policy Implementation in Albania. Agenda Institute (2009)



është nën mbrojtje nga rrjeti Natura 2000, progresi i Shqipërisë në këtë drejtim mund të jetë mjaft i ngadalte për të arritur nivelet e mbrojtjes të këshilluara në direktivat e BE-së.

Zonat e mbrojtura në Shqipëri në fakt janë “të mbrojtura” vetëm në letër, pasi në terren nuk ka ndonjë autoritet (ose kur ka ata janë të korruptuar dhe të paaftë) për të ndaluar gjuetarët e paligjshëm dhe kompanitë përpunimit të drurit të cilat po zhdukin popullata të tera të gjitarëve dhe shpendëve, dhe po zhdukin pyje të tëra në parqet kombëtare.

Vetëm në dy vitet e fundit, Parku Kombëtar i Lurës dhe disa pyje në rajonin e Korçës dhe Kolonjës janë zhdukur thuajse komplet për shkak të prerjeve të paligjshëm. Prerja e këtyre pyjeve shpesh bëhet ditën, ku kanë ndikuar jo pak autoritetet lokale të cilët shpeshherë kanë qenë dhe protagonistët kryesorë ose ortakë me firmat drusore. Përveç shkatërrimit të paligjshëm të pyjeve, problemi është rënduar më tej nga transferimi i dy parqeve kombëtare dhe një pylli bregdetar të kompani industriale të cilat po bëjnë shfrytëzimin e terrenit në Parkun Kombëtar të Krastës, Parkun e Karaburunit dhe Pyllin e Sodës.

Biodiversiteti dhe kafshët e egra janë të dëmtuara mjaft rëndë. Gjuetarë shqiptarë dhe të huaj kanë bërë kërdrinë në kafshët e egra në Shqipëri pasi nuk ka asnjë kontroll se sa ara vrasin edhe në rastin kur ata kanë liçenca. Shumica e zogjve migrues nuk folezojnë më në Shqipëri sipas eksperteve mbi biodiversitetin në Shqipëri, kjo si pasojë e shkatërrimit të çerdheve të tyre dhe gjuetisë shfarosëse ndaj tyre.

Shqipëria është një nga vendet e pakta të Evropës që nuk ka një Ligj të Mbrojtjes së Kafshëve dhe konventat dhe direktivat për mbrojtjen e kafshëve të egra nuk zbatohen, veçanërisht për kafshët që janë nën mbrojtje ose të rrezikuara në BE si arinjte, rrëqebujt, dhe dhitë e egra të cilat gjuhen lirisht në pyjet e Shqipërisë, pa ndonjë autoritet që kontrollon numrat e këtyre kafshëve në natyrë.

Mbajtja e kafshëve të egra në kafaze të vegjël në restorante është mjaft e përhapur, më të paktën dy restorante që zbavitin klientët e tyre me arinj që mbahen në kafaze të vegjël, ose me koka e kufoma arinjsh të balsamosur. Abuzimi i kafshëve është mjaft i përhapur, duke shkaktuar protestë e indinjim të turistëve nga BE-ja që vizitojnë Shqipërinë. Mentaliteti i urrejtjes së kafshëve të egra është mjaft i përhapur dhe do të jetë shumë vështirë të ndryshohet, gjë që mund të bie në kundërshti me përpjekjet për të zbatuar Direktivën e BE-së për kafshët e egra dhe të buta.

Ndotja industriale dhe ajo kimike

Ka mungesa stafi kompetent dhe mungesa mjetesh në inspektoratin mjedisor për të kryer kontrole të duhura dhe verifikime në terren. Shumë fabrika, uzina dhe Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme punojnë pa ndonjë leje mjedisore ose edhe në rastin kur e kanë një, nuk respektojnë rregulloret ndaj mjedisit. Parimi “ndotësi paguan” nuk funksionon në praktikë, ku shumica e gjobave të vendosura ngelen të papaguara si pasojë a paaftësisë së inspektorëve për të mbledhur gjobat e vëna. Numri i inspektorëve mjedisorë për qark është shumë i ulët, me 2-3 inspektorë që duhet të mbulojnë një territor me qindra mijëra banorë dhe biznese, dhe zakonisht duke pasur as një makinë apo kompjuter për të kryer punën.

Një shembull ilustrues është Qarku i Tiranës që përmban disa qytete si

Tirana, Kamza, Vora dhe Kavaja, dhe ka një popullsi prej më shumë se një milion banorë. Megjithatë ky qark ka popullsinë më të madhe në Republikën e Shqipërisë dhe mban gjysmën e industrisë së Shqipërisë, ai ka vetëm 6 inspektorë mjedisorë.

Rasti më i dukshëm është ndotja industriale nga rafineria e Ballshit ku mbetjet nga nxjerrja e naftës derdhen direkt në rrjedha që derdhen në Lumin Gjanca, duke e bërë këtë të fundit lumin të ndotur në



Shqipëri. Ky lumë ka derdhur me dekada mbetje naftë e bitumi në Detin Adriatik, duke ndotur shumë rëndë bregdetin afër grykëderdhjes së Semanit.

Mungon një autoritet që merret me materialet dhe mbetjet e rrezikshme dhe nuk ka një sistem për menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme.

Ndotja akustike

Ende mungon një strategji për të luftuar zhurmat, veçanërisht në zonat urbane ku është kthyer në një zënkë mes bizneseve dhe qytetarëve. Një fushatë disa-mujore e nisur nga media në shtator 2009, mundi të rriste vëmendjen ndaj zhurmave, por zbatimi i ligjit ishte thuajse i pamundur për shkak të ambiguitetit të ligjit dhe mosndarjes së kompetencave nga organe të ndryshme ligjvënëse në këtë drejtim. Ligji aktual nuk specifikon nivelin e zhurmave të cilat një subjekt nuk duhet t'i tejkalojë dhe policia bashkiake, e cila ka për detyrë t'i parandalojë ato nuk ka ndonjë pajisje për matjen e zhurmave. Megjithëse ka pasur disa fushata kontrollesh dhe gjobash të vendosura mbi bare dhe diskoteka, mbledhja e këtyre gjobave përgjithësisht ka dështuar, duke i lejuar këto biznese të vazhdojnë të thyejnë ligjin, duke lejuar zhurma më të larta nga niveli maksimal i 70 dB sipas ekspertëve të shëndetit. Nga ana tjetër, policia rrugore nuk konsideron rënien e borive në zonat urbane dhe rezidenciale si një shkelje të ligjit dhe si zhurmë. Kjo gjë rrit nivelin e zhurmave në nivele të rrezikshme, veçanërisht në orët e pikut të trafikut në zonat kryesore urbane; shembulli më i mirë është Tiranë ku në një minutë mund të dëgjohen me qindra bori në një rrugë të vetme, në të njëjtën kohë dhe për një kohë të gjatë.

Ndryshimet Klimatike

Shqipëria është një vend jo-Aneks I në Konventën Kuadër të Kombeve të Bashkuara mbi Ndryshimet Klimatike prandaj nuk ka kufizime për emetimin e gazrave serrë. Kjo vjen si pasojë e niveleve të ulëta të industrisë që emeton karbon, dhe 98% e energjisë së prodhuar në vend nga burimet hidrike—duke siguruar kështu më pak emetime CO₂ për person në krahasim me shumicën e vendeve industriale.

Megjithatë, kapacitetet administrative dhe teknike, dhe burimet financiare janë të dobëta për një implementim të suksesshëm të kërkesave të legjisllacionit evropian për ndryshimet klimatike. Politika e Shqipërisë në vitet e fundit ka ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme, duke vendosur bazat për të kthyer vendin në një kontribues të CO₂. Qeveria ka dhënë lejen për ndërtimin e 9 fabrikave të çimentos (katër prej të cilave janë ndërtuar dhe 3 janë në ndërtim e sipër), të cilat janë shumë ndotëse jo vetëm për mjedisin në zonën ku ato janë ndërtuar por kontribuojnë edhe në ndryshimet klimatike. Aktiviteti i këtyre fabrikave ka bërë të mundur shkatërrimin e plotë të disa maleve dhe peizazhit në një pjesë të madhe të Ultësirës Perëndimore. Nuk janë bërë ende studime të mirëfillta shkencore për të përcaktuar efektet e shkatërrimit të plotë të maleve mbi biodiversitetin, ajrin, shëndetin dhe ujërat sipërfaqësorë dhe nëntokësorë.

Qeveria ka dhënë lejen për ndërtimin e një centrali me naftë dhe është e vendosur të ndërtojë një ose dy TEC-e me qymyr në zonen e Durrësit megjithëse BE-ja po planifikon të heqë subvencionet për qymyrin dhe të fillojë mbylljen e TEC-eve me qymyr në 2023¹⁶ mes një presioni të fortë nga të Gjellbrit të cilët synojnë të afrojnë datën e mbylljes së TEC-eve me qymyr dhe të promovojnë energjinë e gjelbër.

¹⁶ EU states give 14 more years to dirty coal plants:

<http://af.reuters.com/article/worldNews/idAFTRE65H3L520100618>



Nëse Shqipëria do bëhej vend kandidat apo do të ishte në proces anëtarësimi në 2020, atëherë TEC-et që qeveria do që t'i lejojë të ndërtohen do të përbënin pengesë për ecjen në linjë me politikat e BE-së.

Perceptimi i publikut për mjedisin

Megjithatë duket se perceptimi i publikut nuk është matur dhe për më tepër, një përgjigje e dobët është vënë re në lidhje me krizën mjedisore. Po ashtu, duket se pjesa më e madhe e njerëzve dhe e shoqërisë nuk është familjarizuar me termat e kushtezueshmërisë të *acquis* mjedisore, përfshirjen e detyrueshme dhe zbatimin nga ana e pushtetit legjislativ dhe ekzekutiv në Shqipëri.

Një e dhënë mjaft interesante që gjetëm nga intervistat që kryem për këtë sondazh, ishte fakti që pjesa më e madhe e të intervistuarve, kishin një shkallë të lartë ndjeshmërie në lidhje me çështjet dhe problemet mjedisore por ata priren të reagojnë vetëm me fjalë dhe vetëm kur pyeteshin specifikisht për një gjë të tillë. Thujse të gjitha sondazhet e mëparshme të përgjithshëm kanë qenë përqendruar në problemet kryesore si ekonomia, papunësia, korrupsioni etj, duke mos e përfshirë mjedisin si një çështje që duhej marrë seriozisht në konsideratë. Prandaj personat e intervistuar rrallë, për të mos thënë kurrë, nuk e kanë parë mjedisin si një problem të përditshëm të vendit. Kjo mund të jetë si pasojë pasi mjedisi nuk trajtohet shpesh mes çështjeve të tjera. Duke qenë se media luan një rol kryesor në përhapjen e informacionit por edhe në edukimin e njerëzve, ne i kushtuam rëndësi në këtë studim edhe monitorimit të shtypit të shkruar, duke përzgjedhur pesë gazetat e përditshme me tirazhin më të lartë në vend. Media e shkruar, por edhe vizive ka luajtur një rol kyç në ndërgjegjësimin e publikut në lidhje me disa probleme akute mjedisore. Si raste ilustrative mund të marrim fushatën dy-mujore të gazetës Shekulli për nivelin e lartë të zhurmave të ardhura në zonën e Bllokut dhe në qendër të Tiranës që solli ndërhyrjen e qeverisë qendrore dhe asaj vendore dhe rezultoi në disa aksione në bare dhe klube nate, megjithëse fushata jo afatgjata.

Rezultatet e anketimit

Për të patur një botëkuptim më të plotë empirik për perceptimin e qytetarëve shqiptarë në lidhje me çështjet mjedisore dhe për më tepër matjen e njohurive që ata kanë për *acquis* mjedisore të BE-së, dhe rëndësinë që ka ky legjislacion në jetën e tyre të përditshme, ne kryem një sondazh në qytetin e Tiranës. Kampioni i popullatës që ne morëm ishin 200 të intervistuar, duke mbuluar disa nga zonat më të populluara të qytetit si zonën e Bllokut, Komuna e Parisit, Zogu i Zi, 21-shi, Medreseja etj. Kjo na mundësoi që të flisnim dhe të intervistonim njerëz me origjinë të ndryshme sociale, ekonomike, kulturore dhe arsimore. Ky publikim prezanton perceptimet kryesore mbi mjedisin dhe rolin që ka ai për integrimin e Shqipërisë në BE. Indikatorët e dhënë më poshtë janë bazuar në të dhënat që mblodhëm gjatë muajve Korrik-Gusht 2010 nga anketimi i zhvilluar nga Instituti i Politikave Mjedisore dhe i financuar nga Instituti Friedrich Ebert Stiftung Tirana.

Metodologjia

Anketimi u krye me anë të pyetësorëve që përmbanin 13 pyetje nga fushat kryesore që mbulon dhe Progres Raporti i KE-së mbi mjedisin në Shqipëri, të cilat janë: ajri, ujërat, menaxhimi i mbetjeve, ndotja akustike, parqet kombëtare dhe natyrore, dhe ndotja industriale dhe kimike. Kampioni i popullatës së intervistuar për këtë anketim ishte 200 persona të përzgjedhur në mënyrë të rastësishme në pika të ndryshme të Tiranës. Kampioni prej 200 vetash ishte i ndarë në 4 grupe sipas grupmoshave kryesore në popullsi.

Grupmoshat ishin: mosha 16-30 vjeç, 31-45 vjeç, 46-60 vjeç dhe 61-80 vjeç.

Grupmoshat

16-30	80	40%
31-45	49	24.50%
46-60	44	22%
61-80	27	13.50%
Total	200	100%

Të dhënat u morën më anë të plotësimit në vend të pyetësorit prej 6 faqesh, duke u siguruar që të intervistoheshin një numër i barabartë meshkujsh e femrash. Gjatë intervistimit u morën masa që të ruhej anonimiteti i të anketuarve. Pyetjet ishin kryesisht me mundësi zgjedhjeje mes alternativave, me pyetje që përmbanin dhe nënpyetje për të marrë dhe mendimin personal rreth çështjes së mjedisit si shtyllë kyçe për integrimin në BE të Shqipërisë, dhe pyetje me komente e me shumë nënpyetje siç ishte pyetja se si media trajton mjedisin në kuadër të integritimit evropian të Shqipërisë.

Një marzh i caktuar gabimi është i pritshëm nga anketimi, për shkak të kthimit të shifrave në përqindje, gabimeve në një numër të vogël të pyetësorëve nga personat që i plotësuan ato, dhe moskuptimit të pyetjes nga plotësuesi i pyetësorit.

Përqindja e nivelit të arsimimit të të anketuarve është si më poshtë:

Niveli i arsimimit

I lartë	110	55%
I mesëm	78	39%
I ulët	12	6%
Total	200	100%



Përgjigjet nga anketimi me grafikë

1) Sa të rëndësishme janë politikat dhe masat e marra ndaj ndotjes së ajrit për integrimin e Shqipërisë në BE?

A - shumë të rëndësishme

B - disi të rëndësishme

C - as të rëndësishme por as të parëndësishme—thjesht të nevojshme

D - nuk janë të rëndësishme


dhe sa të rëndësishme janë këto politika për ju personalisht?

A - shumë të rëndësishme

B - disi të rëndësishme

C - as të rëndësishme por as të parëndësishme—thjesht të nevojshme

D - nuk janë të rëndësishme



Ajri dhe masat e marra ndaj ndotjes së tij mendohen si shumë të rëndësishme në Shqipëri. 71.5 përqind e mendojnë këtë, ndërsa 80.5 përqind i shohin politikat dhe masat ndaj ndotjes së ajrit si shumë të rëndësishme. Kjo është një shifër mjaft e lartë që duhet të alarmojë vendimmarrësit, pasi më shumë se $\frac{3}{4}$ e popullsisë e sheh ndotjen e ajrit si shumë të rëndësishme personalisht.



2) Sa të rëndësishme janë politikat dhe masat e marra ndaj ndotjes së ujit për integrimin e Shqipërisë në BE?

A - shumë të rëndësishme

B - disi të rëndësishme

C - as të rëndësishme por as të parëndësishme—thjesht të nevojshme

D - nuk janë të rëndësishme


dhe sa të rëndësishme janë këto politika për ju personalisht?

A - shumë të rëndësishme

B - disi të rëndësishme

C - as të rëndësishme por as të parëndësishme—thjesht të nevojshme

D - nuk janë të rëndësishme



Masat e marra ndaj ndotjes së ujit mendohen si shumë të rëndësishme nga një pjesë e madhe e shoqërisë, por ajo që të bie në sy është se personalisht publiku e percepton çështjen e ndotjes së ujit si më të rëndësishme personalisht.



3) Sa të rëndësishme janë politikat dhe masat e marra ndaj ndotjes së lumenjve, liqeneve dhe detit për integrimin e Shqipërisë në BE?

A - shumë të rëndësishme

B - disi të rëndësishme

C - as të rëndësishme por as të parëndësishme—thjesht të nevojshme

D - nuk janë të rëndësishme


dhe sa të rëndësishme janë këto politika për ju personalisht?

A - shumë të rëndësishme

B - disi të rëndësishme

C - as të rëndësishme por as të parëndësishme—thjesht të nevojshme

D - nuk janë të rëndësishme



Kur u pyetën se sa të rëndësishme janë politikat dhe masat e marra ndaj ndotjes së lumenjve, liqeneve dhe detit për integrimin e Shqipërisë në BE, vetëm 64 përqind e qytetarëve mendojnë se janë shumë të rëndësishme, ndryshe nga ato për ujin e ajrit, ndërsa personalisht, 71.5 përqind e tyre mendojnë se janë shumë të rëndësishme. Gjithashtu kemi rreth 3.5 përqind që mendojnë se këto masa nuk janë të rëndësishme për integrimin në BE.



4) Sa të rëndësishme janë politikat dhe masat e marra për menaxhimin e mbetjeve për integrimin e Shqipërisë në BE?

A - shumë të rëndësishme

B - disi të rëndësishme

C - as të rëndësishme por as të parëndësishme—thjesht të nevojshme

D - nuk janë të rëndësishme


dhe sa të rëndësishme janë këto politika për ju personalisht?

A - shumë të rëndësishme

B - disi të rëndësishme

C - as të rëndësishme por as të parëndësishme—thjesht të nevojshme

D - nuk janë të rëndësishme



Gjithashtu dhe perceptimi për menaxhimin e mbetjeve tregon se qytetarët e mendojnë si diçka që ka më pak rëndësi se sa pastërtia e ajrit apo e ujit për integrimin në BE të Shqipërisë, por i japin një peshë mjaft të rëndësishme, 72.5 përqind në aspektin personal.



5) Sa të rëndësishme janë politikat dhe masat e marra ndaj trajtimit të ujërave të zeza për integrimin e Shqipërisë në BE?

A - shumë të rëndësishme

B - disi të rëndësishme

C - as të rëndësishme por as të parëndësishme—thjesht të nevojshme

D - nuk janë të rëndësishme


dhe sa të rëndësishme janë këto politika për ju personalisht?

A - shumë të rëndësishme

B - disi të rëndësishme

C - as të rëndësishme por as të parëndësishme—thjesht të nevojshme

D - nuk janë të rëndësishme



Trajtimi i ujërave të zeza perceptohet vetëm nga 63.5 përqind e qytetarëve si politika të rëndësishme për integrimin e Shqipërisë në BE, por në aspektin personal e shohin si mjaft të rëndësishme, me 74.5 përqind që e perceptojnë në këtë mënyrë. Ajo që të bie në sy është dhe fakti që rreth 19 përqind e perceptojnë trajtimin e ujërave të zeza si diçka që nuk është e rëndësishme për integrimin e Shqipërisë



në BE por si diçka të nevojshme, dhe 5 përqind nuk e shohin fare të nevojshme për integrimin në BE, një shifër mjaft e lartë në krahasim me pyetjet e tjera me lart.

6) Sa të rëndësishme janë politikat dhe masat e marra ndaj zhurmave (ndotjes akustike) për integrimin e Shqipërisë në BE?

A - shumë të rëndësishme

B - disi të rëndësishme

C - as të rëndësishme por as të parëndësishme—thjesht të nevojshme

D - nuk janë të rëndësishme


dhe sa të rëndësishme janë këto politika për ju personalisht?

A - shumë të rëndësishme

B - disi të rëndësishme

C - as të rëndësishme por as të parëndësishme—thjesht të nevojshme

D - nuk janë të rëndësishme



Ndërsa në pyetjen rreth ndotjes akustike, vetëm gjysma e qytetarëve mendon se luan rol shumë të rëndësishëm për integrimin e Shqipërisë në BE, një shifër mjaft e ulët në krahasim me pyetjet e tjera më lart; është interesante që kemi përqindje të konsiderueshme që e konsiderojnë disi të rëndësishme (23 përqind) dhe thjesht të nevojshme (20.5 përqind), dhe 6.5 përqind që e konsiderojnë si të parëndësishme për integrimin në BE. Në aspektin personal masat e marra ndaj ndotjes akustike vlerësohen më shumë,


dhe kjo vjen ndoshta nga fakti që ka pasur mjaft fushata në media dhe nga policia për uljen e ndotjes akustike, por asnjëherë nuk është vënë në pah që ndotja akustike është dhe një ndër përbërësit e standardeve evropiane për integrimin në BE.

7) Sa e rëndësishme është mbrojtja e parqeve kombëtare, dhe parqeve natyrore për integrimin e Shqipërisë në BE?

- A - shumë e rëndësishme
- B - disi e rëndësishme
- C - as e rëndësishme por as e parëndësishme—thjesht e nevojshme
- D - nuk është e rëndësishme

dhe sa e rëndësishme është mbrojtja e parqeve për ju personalisht?

- A - shumë e rëndësishme
- B - disi e rëndësishme
- C - as e rëndësishme por as e parëndësishme—thjesht e nevojshme
- D - nuk është e rëndësishme



Mbrojtja e parqeve kombëtare e natyrore ka shumë rëndësi për qytetarët si për integrimin e Shqipërisë në BE, ashtu dhe personalisht, siç shihet edhe në komentet që qytetarët kanë vendosur në pyetësorë. Kjo tregon që ka pasur mjaft ndërgjegjësim në këtë fushë, ose që qytetarët e vuajnë personalisht mungesën e gjelbërimit në zonat urbane, duke i çuar një sinjal të qartë vendimmarrëseve.



8) Sa janë të trajtuara në mediat shqiptare këto ndryshime në kuadër të kriterëve të integritimit në BE, sipas mendimit tuaj?

(i) Ndotja e ajrit; a është ajo:

- A - e trajtuar shumë mirë në media
- B - disi e trajtuar
- C - e trajtuar shumë rrallë
- D - nuk trajtohet kurrë

(ii) Ndotja e ujit; a është ajo:

- A - e trajtuar shumë mirë në media
- B - disi e trajtuar
- C - e trajtuar shumë rrallë
- D - nuk trajtohet kurrë

(iii) Ndotja e lumenjve, liqeneve dhe deteve; a është ajo:

- A - e trajtuar shumë mirë në media
- B - disi e trajtuar
- C - e trajtuar shumë rrallë
- D - nuk trajtohet kurrë

(iv) Menaxhimi i mbetjeve; a është ai:

- A - i trajtuar shumë mirë në media
- B - disi i trajtuar
- C - i trajtuar shumë rrallë
- D - nuk trajtohet kurrë

(v) Trajtimi i ujërave të zeza; a është ai:

- A - i trajtuar shumë mirë në media
- B - disi i trajtuar
- C - i trajtuar shumë rrallë
- D - nuk trajtohet kurrë

(vi) Ndotja akustike; a është ajo:


- A - e trajtuar shumë mirë në media
- B - disi e trajtuar
- C - e trajtuar shumë rrallë
- D - nuk trajtohet kurrë

(vii) Mbrojtja e parqeve kombëtare dhe natyrore; a është ajo:


- A - e trajtuar shumë mirë në media
- B - disi e trajtuar
- C - e trajtuar shumë rrallë
- D - nuk trajtohet kurrë



8) Sa janë të trajtuara në mediat shqiptare këto ndryshime në kuadër të kriterëve të integritit në BE, sipas mendimit tuaj? (i) Ndotja e ajrit; (ii) Ndotja e ujit; (iii) Ndotja e lumenjve, liqeneve dhe deteve;



8) Sa janë të trajtuara në mediat shqiptare këto ndryshime në kuadër të kriterëve të integritit në BE, sipas mendimit tuaj? (iv) Menaxhimi i mbetjeve; (v) Trajtimi i ujërave të zeza; (vi) Ndotja akustike; (vii) Mbrojtja e parqeve kombëtare dhe natyrore





Pyetja rreth trajtimit nga media të çështjeve kryesore mjedisore në kuadër të integritit të Shqipërisë në BE është pyetje mjaft e rëndësishme, pasi media është faktori kryesor në përçimin e informacionit dhe politikave te qytetarët në Shqipëri sipas disa anketimeve të tjera nga OJF të ndryshme në Shqipëri. Në këtë pyetje me shumë nënpyetje në çështjet kryesore të mjedisit që trajton progres raporti i KE-së (ndotja e ajrit, uji, lumenjve, liqeneve, deteve, menaxhimi i mbetjeve, trajtimi i ujërave të zeza, ndotja akustike, dhe mbrojtja e parqeve kombëtare dhe natyrore), del në pah perceptimi që këto çështje janë disi të trajtuara nga mediat në Shqipëri në kuadër të integritit në BE, dhe në rastin e ndotjes së lumenjve, liqeneve, deteve dhe menaxhimit të mbetjeve del që është e trajtuar shumë rrallë (duke marrë dhe përqindjen më të lartë në pyetjen për menaxhimin e mbetjeve ku 38.5 përqind e qytetarëve mendojnë se është trajtuar shumë rrallë). Gjithashtu kemi dhe shifra të konsiderueshme përqindjesh të qytetarëve që perceptojnë se media nuk i ka trajtuar asnjëherë këto çështje në kuadër të integritit të Shqipërisë në BE, me përqindjen më të lartë në pyetjen rreth menaxhimit të mbetjeve, ku 16 përqind mendojnë se nuk është trajtuar asnjëherë si çështje. Ky është një mesazh mjaft i rëndësishëm për median që u tregon se duhet t'i japin më shumë rëndësi dhe hapësirë kësaj çështjeje në programin e tyre.



9) A mendoni se mjedisi është prioritet në axhendën e politikës shqiptare në kuadër të integrimit Evropian?

A - shumë i rëndësishëm

B - disi i rëndësishëm

C - as i rëndësishëm por as i parëndësishëm—thjesht i nevojshëm

D - nuk është i rëndësishëm


dhe sa i rëndësishëm është mjedisi për ju personalisht?

A - shumë i rëndësishëm

B - disi i rëndësishëm

C - as i rëndësishëm por as i parëndësishëm—thjesht i nevojshëm

D - nuk është i rëndësishëm




Kjo pyetje merr një rëndësi të veçantë për politikën shqiptare, pasi tregon se sa qytetarët mendojnë se mjedisi është prioritet i rëndësishëm në axhendën e politikës shqiptare në kuadër të integrimit evropian. Vetëm 41.5 përqind mendojnë se mjedisi është prioritet i rëndësishëm në axhendën e politikës shqiptare në kuadër të integrimit evropian, dhe më pas shifrat vijnë duke u ulur me 32.5 përqind që mendojnë ai është prioritet disi i rëndësishëm, 17 përqind që mendojnë se është prioritet thjesht i nevojshëm dhe me 9 përqind që mendojnë se është prioritet jo i rëndësishëm në axhendën e politikës shqiptare në kuadër të integrimit evropian. Është shumë interesante që kemi një shifër të madhe prej 91.5 përqind të qytetarëve

që e kanë mjedisin një çështje shumë të rëndësishme personalisht, duke treguar një hendeq të madh mes asaj që votuesit duan dhe asaj që politika shqiptare u ofron.

10) A mendoni se Komisioni Evropian në Shqipëri e ngre mjedisin si çështje që luan rol në integrimin e Shqipërisë në BE?

- A - shumë
- B - disi
- C - aspak
- D - nuk e di
- E - tjetër (shpjegoni)



Nga kjo pyetje është interesante të shihet që edhe vetë Komisioni Evropian në Shqipëri që trajton progres raportet për Shqipërinë, perceptohet se e ngre disi mjedisin si çështje që luan rol në integrimin e Shqipërisë në BE (40.5 përqind e qytetarëve e mendojnë këtë). Vetëm 35 përqind e mendojnë se KE ngre shumë mjedisin si një çështje që luan rol në integrimin e Shqipërisë në BE, dhe 5 përqind mendojnë se KE nuk e ngre aspak këtë çështje. Gjithashtu, 15 përqind e qytetarëve nuk e dine dhe 4.5 përqind shpjegojnë me komente që KE nuk luan një rol të mjaftueshëm ndaj autoriteteve shqiptare në këtë fushë. Këto rezultate janë shumë të rëndësishme për punën e KE-së në Shqipëri, pasi tregojnë se KE-ja duhet të reklamojë e të bëjë më shumë në ngritjen e kësaj çështjeje si në media dhe sidomos gjatë publikimit të progres raportit, po ashtu edhe në mendimet që i dërgon qeverisë shqiptare. Fakti që 15 përqind e




qytetarëve nuk kanë informacion rreth kësaj çështjeje, tregon që KE-ja duhet të bëjë më shumë rreth përhapjes së informacionit.

11) Sa të rëndësishme janë masat e marra ndaj ndotjes industriale dhe kimikateve për integrimin e Shqipërisë në BE?

- A - shumë të rëndësishme
- B - disi të rëndësishme
- C - as të rëndësishme por as të parëndësishme—thjesht të nevojshme
- D - nuk janë të rëndësishme

dhe sa të rëndësishme janë këto masa për ju personalisht?

- A - shumë të rëndësishme
- B - disi të rëndësishme
- C - as të rëndësishme por as të parëndësishme—thjesht të nevojshme
- D - nuk janë të rëndësishme



Masat dhe politikat ndaj ndotjes industriale dhe kimikateve për integrimin e Shqipërisë në BE duket që perceptohet si mjaft e rëndësishme nga qytetarët , po ashtu edhe në nivelin personal.



12) A mendoni se shoqëria shqiptare është e kënaqur me standardet mjedisore në vend?


A - shumë

B - disi

C - aspak

D - nuk e di

E -tjetër (shpjegoni)




Kjo pyetje nxjerr në pah pakënaqësinë që ka shoqëria shqiptare ndaj standardeve mjedisore në vend ku 64.5 përqind e qytetarëve janë aspak të kënaqur me standardet aktuale, vetëm 21.5 përqind janë disi të kënaqur dhe vetëm 5.5 përqind janë shumë të kënaqur. 6 përqind që kanë dhënë përgjigjen me komente, shprehin një pakënaqësi të lartë ndaj gjendjen mjedisore në Shqipëri.



13) Sa e rëndësishme është puna e shoqërisë civile për ndërgjegjësimin ndaj çështjeve mjedisore?

- A - shumë
- B - disi
- C - aspak
- D - nuk e di
- E - tjetër (shpjegoni)



59 përqind e qytetarëve mendojnë se shoqëria civile luan një rol shumë të rëndësishëm për ndërgjegjësimin ndaj çështjeve mjedisore, 30 përqind mendojnë se ajo luan disi rol në ndërgjegjësimin rreth këtyre çështjeve dhe vetëm 4.5 përqind mendojnë se ajo nuk luan aspak rol në këtë çështje. Edhe në komente vihet re një dhënie roli të rëndësishëm shoqërisë civile në ndërgjegjësim rreth çështjeve mjedisore, por kishte dhe komente ku kritikohet indiferentizmi apo diferencimi i një pjese së shoqërisë civile ndaj kësaj çështjeje.



Komentet

Gjatë plotësimit të pyetësorëve kishte gjithsej 17 komente.

Analiza e komenteve të marra nga pyetësorët, nxjerr në pah një pakënaqësi të lartë ndaj gjendjes së mjedisit në Shqipëri. Ajo që bie më tepër në sy është se shumica e komenteve paraqesin dhe kritikojnë KE-në si një palë që nuk ushtron presionin e duhur mbi autoritetet shqiptare që të plotësohen standardet mjedisore të BE-së, dhe kritikohet se mjaftohet vetëm me plotësimin e standardeve politike dhe ekonomike. Pika tjera që të bien në sy tek komentet është se publiku shqetësohet shumë për shkatërrimin e mjediseve të gjelbra e parqeve, si dhe mendon se shoqëria civile luan një rol të rëndësishëm për ndërgjegjësimin e publikut. Në disa komente vihet re që qytetarët kritikojnë diferencimin e shoqërisë civile ndaj përkushtimit rreth çështjeve mjedisore, ku disa bëjnë më shumë ndërgjegjësim e disa të tjerë aspak.

Për më shumë detaje mbi rezultatet e sondazhit sipas grup moshës dhe arsimimit, shikoni **Aneksin 1**.

Monitorimi i Medias

Një prej fazave të projektit ishte monitorimi i medias së shkruar për një periudhë dy mujore. Pesë gazetat e përzgjedhura për analizë ishin të përditshmet më të mëdha: Panorama, Shekulli, Shqip, Standard dhe Gazeta Shqiptare. Gjatë monitorimit ne u fokusuam në tre shtylla: a. Informacion mbi artikullin; b. Lajmi dhe c. Analiza për artikullin.

Në seksionin e informacionit të artikullit ne renditëm; a. Tipin e lajmit: artikull, opinion, reportazh, ese, përkthim nga media e huaj; b. Vendndodhja e artikull (faqe e parë; numri i faqes); c. Numri i faqeve të gazetës; d. Titulli i artikullit (gërma të mëdha të theksuara, në pjesën e sipërme të faqes, shkrim i zmadhuar etj).

Në seksionin e lajmeve, ne renditëm nënseksionet e mëposhtme: Çështja që trajtohet (ajri, uji, toka, ndotja akustike, mbetjet, pyjet, integrimi dhe mjedisi etj); b. Diskutimi i çështjes në nivel: kombëtar, ndërkombëtar, rajonal; c. Fotografi (po/ jo).

Në seksionin e analizës së artikullit, ne renditëm nënseksionet e mëposhtme: analiza e artikullit: gjuha e përdorur, neutraliteti, toni i gjuhës, paragjykime nëse ka, u analizua veçanërisht nëse në artikull ishte diskutuar mbi integrimin e Shqipërisë në BE, a është artikulli i qartë, cilat janë pikat mbizotëruese, a janë përmendur të gjitha grupet në artikull, a ka ndonjë kontradiktë etj.

Në këtë raportim të shkurtër të rezultateve të monitorimit tonë është e pamundur të përfshihen të gjitha të dhënat sasiore që kemi mbledhur dhe të raportojmë në mënyrë të plotë gjetjet, por besojmë se materiali i përmbledhur përbën një fotografi të përgjithshme të masmedias lidhur me çështjet mjedisore në Shqipëri. Megjithatë, ne do të përpiqemi të shfaqim shkurtimisht disa nga gjetjet e rëndësishme si numri i faqeve të artikujve, lajmeve, reportazheve, opinionëve, komenteve ose promovimit/ publicitetit duke i renditur ato në bazë të shpeshtësisë, tipit, spikatja krahas artikujve të tjerë, nëse çështja është lokale, rajonale ose ndërkombëtare dhe cila është tema më e trajtuar për mjedisin: ajri, uji, toka, ndotja



akustike, mbetjet, pyjet, integrimi dhe mjedisi apo diçka tjetër.¹⁷ Duhet theksuar se periudha dymujore e monitorimit filloi në 6 Korrik dhe përfundoi në 6 Shtator, pa ndërprerje.

Rezultatet e përgjithshme të monitorimit jepen në vijim:

Në periudhën 2 mujore të monitorimit të pesë gazetave, në total u evidentuan një numër prej 439 artikujsh të shkurtër dhe të gjatë, lajme, reportazhe, opinione, komente ose promocion/publicitet (të lidhura me çështjet mjedisore). Gazeta Panorama kishte një numër prej 82 në total; 35 në Korrik, 40 në Gusht dhe 7 në ditët e para të Shtatorit. Shekulli kishte 81 artikuj; 25 në Korrik dhe 49 në Gusht, plus 7 në javën e parë të Shtatorit. Gazeta Shqip kishte 117 artikuj i cili është numri më i lartë i artikujve mjedisorë në gazetat shqiptare, prej të cilave 38 i përkisnin muajit Korrik, ndërsa Gushti kishte përqendrimin më të madh me 74 copë, dhe 5 artikuj në javën e analizuar të Shtatorit. Gazeta Shqiptare kishte një total prej 109 artikujsh me 39 artikuj në Korrik, 74 në Gusht dhe 8 në Shtator. Gazeta Standard kishte numrin më të vogël me 49 artikuj në total, prej të cilave 18 ishin në Korrik, 25 në Gusht dhe 6 në ditët e para të Shtatorit.

Shih numrin në tabelën 1.1 dhe 1.2 për më shumë detaje.

		Artikuj/lajm	Opinione/ Komente/ Analiza	Reportazhe	Trajtesa të plota	Intervista	Promocione	Të tjera
Shekulli	N=25	16	3	1	4	1	0	0
Shqip	N=38	25	5	1	0	0	0	4 (përkthime)
GSH	N=39	30	3	0	1	1	1	1 T
Panorama	N=35	24	9	0	0	0	2	0
Standard	N=18	15	2	0	0	0	1	0
Totali	N=155	N=110	N= 17	N=2	N=5	N=2	N=4	N=5

Tabela1.1

6 Korrik 6- Gusht

¹⁷ Lidhur me pikën e fundit të përmendur duhet të theksohet se jo shumë kohë më parë, në një periudhë të pa mbuluar nga monitorimi ynë dy mujor, gazeta Shekulli inicioi për disa muaj një alarm në media mbi ndotjen akustike, ku Instituti i Politikave Mjedisore (IEP) dha kontributin me formën e një artikulli.



		Artikuj/l ajm	Opinione/ Komente/ Analiza	Reportazhe	Trajtesa të plota	Intervista	Promocione	Të tjera
Shekulli	N=56	39	12	0	3	0	1	1 (përkthi me)
Shqip	N=76	62	10	1	0	0	1	1 intervista ; 1 fotolajm
GSH	N=69	55	4	1	1	4	0	2 fotoartik ull; 1 an; 1(përkthi m)
Panorama	N= 46	39	4	0	1	1	1	
Standard	N= 31	28	1	0	0	0	0	2 an
Totali	N= 278	N= 223	N= 31	N= 2	N= 5	N= 5	N= 3	N= 9

Tabela 1.2 6 Gusht - 6 Shtator

Nga të dhënat ne mund të nxjerrim disa rezultate sasiore dhe cilësore. Për sa i përket rezultateve sasiore, lidhur me çështjet mjedisore Gazeta Shqip dhe ajo Shqiptare kanë numrin më të madh të lajmeve, artikujve, opinioneve, komentimeve e kështu me rradhë. Gazeta Standard ka numrin më të vogël, gazeta Panorama dhe Shekulli, që janë dy të përditshmet me tirazhin më të madh prej 20.000 kopjesh qëndrojnë midis.

Lidhur me shpeshtësinë e artikujve të tillë duhet theksuar se në disa data të caktuara, shpeshtësia e artikujve ishte më e lartë se në ditë të tjera për shkak të një lajmi të veçantë mjedisor. Një shembull i tillë është 15 Korriku, ku Gazeta Shqiptare pati 6 artikuj të ndryshëm mjedisor vetëm në një numër të gazetës, Panorama kishte 4 në po të njëjtën ditë, ose në 21 Gusht kur gazeta Shqip pati 7 artikuj dhe Gazeta Shqiptare kishte 5.

Arsyeja pse ndodh kjo vjen për shkak të një ndodhie të pazakontë sikurse mund të jetë takimi i Ministrit të Mjedisit të Shqipërisë me Agjencitë Rajonale Mjedisore ose çështja e trajtimit të ujërave të zeza, ose ndotja e ujit të pijshëm, i cili u kthye në shqetësimin e ditës. Një shembull tjetër por që zgjati më shumë se një ditë ishte aksioni i ndërmarrë nga Ministria e Mjedisit për të ndërprerë lidhjet e ujërave të zeza në zonën e plazhit në Golem, e cila shkaktoi një debat edhe mbi vonesën e ndërhyrjes.



Një tjetër pikë e rëndësishme që kërkon analizim është se çfarë tipi lajmi mjedisor ka mbizotëruar gjatë kësaj periudhe.

Duke filluar nga data 7, kur lajmi i aprovimit të 14 depozitave të gazit dhe ndërtimi i disa Hidrocentraleve dhe fabrikat e çimentos në Lezhe u bënë çështja e ditës në artikuj, sikurse data 17 Korriku në të cilën u fol mbi ndotjen e një zone të plazhit e shkaktuar nga ushtria. Në këtë të fundit flitej mbi erën e keqe, rërën e ndotur, mbetjet metalike dhe kështu me rradhë. Një shembull tjetër duke filluar nga 8 Gushti dhe për disa ditë është çështja e ndotjes së ujit të detit nga ujërat e zeza në Vlorë e cila u bë shqetësim jo vetëm në stilin gazetaresk, por në disa komente shihej ndjeshmëria që kishte shkaktuar çështja në fjalë.

Publiciteti/ artikujt e promovimit sikurse në 14 Gusht flasin për aktivitete mjedisore për ndërgjegjësimin dhe pastrimin e plazheve p.sh., nga Korpusi i Vullnetarëve dhe AMC dhe Free Think Forum që nuk janë të zakonshme. Aksionet janë cituar në detaje (cili ishte fokusi i tyre, organizimi i aksionit, si dhe ku etj). Ky artikull përfundon duke promovuar financimin nga donatori AMC. Gjithsesi, ky artikull duket të jetë më shumë publicitet për organizatën dhe donatorin se sa një aksion real (pa mohuar aksionet e shkuara të tyre). Shumë artikuj të ngjashëm janë publicitet i hapur mbështetës për donatorin, më shumë se sa një aksion ndërgjegjësues për mjedisin.

Së fundmi, ajo që është çështja më e rëndësishme, është çështja për rëndësinë e lidhjes midis procesit të integritit dhe lajmi/ informimi i publikut. Si reflektohet kjo në shtypin Shqiptar? Përgjithësisht për këtë çështje mund të themi se artikujt e kësaj natyre janë të pakët për të mos thënë të rrallë. Kjo vjen për disa arsye. E para dhe më e rëndësishmja është se detyra e parë e medias është të raportojë, e cila zakonisht përbën 90% të artikullit/ lajmit. Së dyti është funksioni i edukimit të opinionit publik i cili zakonisht kryhet duke lënë një seksion për analiza/ komente dhe opinione. Lajmi nuk mund të reflektojë mbi reformat e mjedisit - integritit të BE, derisa disa të dhëna të reflektojnë lidhje të tilla, si p.sh., aktiviteti i Ministrisë të Mjedisit për të kaluar legjislativonin që është i përshtatshme me *acqui communautaire* dhe aktivitete të ngjashme. Kjo i lë opinionet dhe analizat e pavarura për të kryer këtë gjë, por përgjithësisht ato mungojnë në monitorimin tonë të shkurtër të medias.

Seminar (*workshop*)

Gjetjet e sondazhit u përforcuan edhe në opinionet dhe reagimet që ne morëm në një seminar të organizuar në Tiranë, në 8 Nëntor 2010.

Si të rritim vëmendjen e vendimmarrësve për spikatjen e mjedisit në procesin e integritit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian? Reagimi që ne morëm nga ky grup mund të përmbledhet si më poshtë:

1. Ligjvënësit shqiptarë kanë përshtatur *acquis* mjedisor të BE, por nuk kanë marrë në konsideratë kontekstin shqiptar dhe shpesh ligjet janë larg nga zbatueshmëria.
2. Nevoja për marrëdhënie të përqendruara publike të OJF-ve me qëllim për të rritur dukshmërinë e tyre. Ata kanë nevojë për të kontraktuar agjenci profesionale për “PR” dhe marketing në mënyrë që të jenë të aftë për të arritur më shumë sukses në të ardhmen.
3. Themelimin e një lëvizjeje ‘të rinjtë për një mjedis më të pastër’ për t’i dhënë një shtysë të re organizimit të lëvizjes sociale në fushën e mbrojtës së mjedisit.



4. Lobimi për lidhje më të madhe të aktorëve dhe faktorëve që punojnë në sektorin e shoqërisë civile për ndërgjegjësimin mbi mjedisin. Organizimi i konferencave të përbashkëta, seminareve, takimeve në bashkëpunim me media të ndryshme, shoqërisë civile dhe aktorëve akademikë që merren me çështjet e mjedisit.
5. Organizimi i aktiviteteve konkrete që kanë ndikim të drejtpërdrejtë për vendimmarrësit politikë.
6. Nevoja për depolitizimin e aktorëve të shoqërisë civile, e cila ndonjëherë është larg nga realiteti.
7. Nxitja e krijimit të departamenteve të veçanta që kanë të bëjnë me mjedisin, brenda medias vizive dhe asaj të shkruar.
8. Fokusim në marrëdhënien shkak-pasojë të çështjeve mjedisore dhe problemeve shëndetësore.

Alternativat e Politikave

Si mund të mënjanojë Shqipëria efektet e padëshiruara të një progresi të ngadaltë në zbatimin e kriterëve mjedisore të BE-së dhe në të njëjtën kohë të shmangë përsëritjen e gabimeve që bëri Bullgaria dhe Rumania? Mënyrat për të shmangur këtë janë disa; ne kemi zgjedhur ato që janë më të arritshme dhe realiste:

*Vazhdim i hapave aktualë të transpozimit dhe zbatimit të *acquis* mjedisore të BE-së*

[1] Megjithëse legjislacioni vertikal është transponuar, vendosja në një linjë me *acquis* mjedisore të BE-së të legjislacionit horizontal është ende e dobët. Nevojiten përpjekje të mëtejshme për të finalizuar këtë vendosje në linjë me legjislacionin e BE-së, dhe nëse vazhdohet me hapat aktualë të transpozimit të ligjeve dhe me modelin aktual të zbatimit të tyre, Shqipëria rrezikon të mos arrijë kriteret e BE-së duke rrezikuar refuzimin e aplikimit të saj për anëtarësim në BE edhe sikur Shqipëria të bëhet vend kandidat në një të ardhme të afërt. Refuzimi nga Komisioni Evropian i aplikimit të Shqipërisë për t'u bërë vend kandidat u refuzua për shkak të kriterëve politike, por në çastin që këto kritere përmbushen, kriteret mjedisore mund të dalin në pah si shumë të vështira për t'u përmbushur, dhe kjo gjë mund të ndalë ose të ngadalësojë anëtarësimin e Shqipërisë në BE. Edhe sikur Shqipëria të kalojë testin e pranimit si vend kandidat, problemet mjedisore të grumbulluara përgjatë viteve mund të bëhen një pengese serioze për procesin e anëtarësimit, ndoshta duke e ngadalësuar ose vonuar këtë proces.

Mbështetje në fondet IPA për zbutur dëmin mjedisor në Shqipëri

[2] Kjo mund të jetë një zgjidhje afatshkurtër, por përvoja ka treguar se thjesht marrja e fondeve, edhe kur kjo vjen nga donatorë të ndryshëm, nuk e zgjidh problemin—në fakt e zbut problemin në projekte



specifike që mund të zbatohen në zona të ndryshme të vendit, por standardet e përgjithshme mjedisore të vendit nuk ndryshojnë në mënyrë thelbësore dhe jo në mënyrë afatgjatë. Mbështetja vetëm në fondet IPA mund të krijojë iluzionin se çdo gjë po shkon mirë e qetë dhe se do të ketë gjithmonë fonde të jashtme për problemet mjedisore që ka Shqipëria.

Lëre shoqërinë civile ta zgjidhë problemin

[3] Mjedisi është një fushe e madhe dhe e kushtueshme për t'u trajtuar. Është bashkësia ku kryhen të gjitha aktivitetet njerëzore—shoqëria, ekonomia, politika, të gjitha këto ekzistojnë brenda mjedisit dhe nuk mund të ekzistojnë pa mjedisin. Meqenëse se dëmi mjedisor në të kaluarën dhe ai aktual është i konsiderueshëm, si dhe politikat dhe tendencat rreth mjedisit nuk duken të favorshme e të qëndrueshme dhe këto mund të shkaktojnë pengesa në integrimin e Shqipërisë në BE, kostot nga kjo duken gjithashtu të mëdha nëse koncepti i parandalimit nuk aplikohet sa më shpejtë që të jetë e mundur. Shoqëria civile nuk mund të ndryshojë gjendjen e mjedisit e vetme, veçanërisht nëse biznesi (dhe biznesi ndotës) është përzier me politiken, si dhe duke qenë se kostot për përmirësimin e gjendjes mjedisore janë shumë të mëdha, dhe vetëm një qeveri mund t'i përballojë ato dhe ta ndryshojë situatën.

Prit për ndërhyrjen e BE-së në mjedisin në Shqipëri

[4] Kjo mund të jetë një strategji mbi të cilën Shqipëria nuk mund të vërë bast. Të presësh për një organizëm ndërkombëtar që të vijë e të ndryshojë situatën nuk është një strategji realiste dhe mund të jetë fatale për integrimin e Shqipërisë në BE dhe për qëndrueshmërinë mjedisore—e cila mund të krijojë një situatë të pakëndshme për qëndrueshmërinë ekonomike gjithashtu.

Reformë tërësore dhe ndryshim i mënyrës se si trajtohet mjedisi

[5] Një rishikim tërësor i planifikimit strategjik, koordinim mes institucioneve të qeverisë qendrore dhe atyre vendore, nevojitet sigurim i fondeve për financimin e zbatimit të ligjeve, ngritja e një fondi të dedikuar për mjedisin (thelbësor për zbatimin e shumë ligjeve mjedisore), të sigurohet zbatimi dhe imponimi i duhur i ligjeve, dhe një bashkëpunim i fuqishëm me OJF-të dhe shoqërinë civile e median në mënyrë që të arrihet përparimi në fushën e mjedisit—të gjitha këto mund të jenë disa nga aspektet e këtij rishikimi tërësor të mënyrës se si trajtohet mjedisi në Shqipëri. Zhvillimi i një sistemi informimi dhe monitorimi mjedisor gjithëpërfshirës përmes gjithë sektorëve, forcimi dhe thithja e një administrate kompetente, grante të rezervuara për një synim të caktuar dhe një bashkëpunim më i ngushtë me qeveritë vendore, rritja e kapaciteteve dhe fuqisë ligjore që kanë inspektoratet, mund të jenë reforma të mundshme në administrate për të arritur përmirësim në gjendjen e mjedisit.

Një rishikim tërësor i mënyrës se si shqiptarët (duke përfshirë politiken dhe qeveritë shqiptare) e shohin dhe trajtojnë mjedisin do të ishte një mënyrë afatgjatë dhe e sigurt për të arritur standardet mjedisore të BE-së dhe për të siguruar një zbatim të *acquis* mjedisore. Kjo jo vetëm që hap rrugën për një integrim të Shqipërisë në BE, por edhe siguron një të ardhme të qëndrueshme për vendin dhe ekonominë shqiptare.



Përfundime dhe Rekomandime

Ky studim, megjithëse i kufizuar, tregoi se Shqipërinë e pret një rrugë e gjatë për të përmbushur standardet mjedisore sipas BE-së dhe për të arritur standardet që kanë vendet e tjera anëtare të BE-së në mjedis. Ritmi i hapave aktualë të Shqipërisë në këtë fushë, nuk do t'i sigurojë vendit një anëtarësim të shpejtë në BE. Rumania dhe Bullgaria patën një nivel bazë të ulët në standardet mjedisore të BE-së, gjë që u solli shumë pengesa përgjatë rrugës për integrim në BE. Megjithëse anëtare e BE-së, Bullgaria tregoi një shembull klasik se sa e vështirë është ndryshimi në një kohë të shkurtet të situatës mjedisore dhe mentalitetit rreth mjedisit. Pasojat ishin të dukshme—edhe pas anëtarësimit të saj në BE, Bullgaria ende po përpiqet të përmbushë direktivat e BE-së mbi mjedisin. Nga ana tjetër, Shqipëria ka një pikë fillimi më të ulët se Bullgaria dhe situata e mjedisit në dhjetë vitet e fundit nuk duket premtuese për një rehabilitim të shpejtë dhe qëndrueshmëri. Pozicioni i Shqipërisë bëhet edhe më i vështirë rreth gjendjes së mjedisit të saj duke pasur parasysh që BE-ja po sheh për rregulla më të forta për vendet aplikante për në BE.

Të dhënat nga anketimi na treguan që publiku i jep shumë rëndësi mjedisit dhe se është i irrituar me situatën mjedisore në Shqipëri. Ekziston një hendek i madh mes asaj që votuesit duan dhe çfarë politika shqiptare ofron, sipas rezultateve të anketimit. Pika tjetër shqetësuese që del nga rezultatet e anketimit, është se një pjesë e publikut tregon shenja hutimi dhe mungese të informacionit rreth rëndësisë që ka vendosja e standardeve mjedisore shqiptare me ato të BE-së. Publiku percepton se media nuk po trajton mjedisin dhe nuk vendos theksin e duhur në çështjet mjedisore, një perceptim që del i saktë sipas monitorimit të medias së shkruar. Politika dhe media duket sikur i japin publikut të kundërtën e asaj që ai kërkon. Dhe politika e media mund të jenë vendimtare në ndryshimin e sjelljes së shqiptareve ndaj mjedisit, dhe në këtë mënyrë i hapin rrugën Shqipërisë për një integrim në BE më të shpejtë dhe më me pak kosto.

Shqipëria duhet të bëjë përpjekje të vazhdueshme për të vënë legjislacionin e saj në linjë me atë të BE-së dhe për ta zbatuar dhe imponuar atë në mënyrë efektive. Burimet dhe kapacitetet njerëzore dhe teknike në fushën e mjedisit janë të kufizuara dhe financimi rreth mjedisit është më i ulëti në krahasim me fushat tjera ku ndërhyjnë qeveria (Ministria e Mjedisit është ministria më pak e financuar në krahasim me ministritë e tjera).



Rekomandime praktike

Cilat janë rekomandimet praktike që dalin nga studimi? Ato mund të përmbliidhen në pikat e mëposhtme:

- *Rritje e shpejtësisë së transpozimit të legjislacionit shqiptar me atë të BE-së dhe koordinimi mes autoriteteve.* Shpejtësia e transpozimit të legjislacionit horizontal është e ulët dhe kjo gjë është pranuar edhe nga Raport Progresi i Misionit të Komisionit Evropian në Shqipëri. Mungesa e koordinimit mes autoritete dhe institucioneve, nganjëherë duke sjellë përplasje të kompetencave të tyre, projekteve dhe politikave, ka sjellë një situatë ku nuk ka përparim për shkak të mungesës së përgjegjësive të qarta.
- *Nevojitet zbatimi i ligjeve të aprovuara.* Thjesht transpozimi i *acquis* mjedisore në legjislacionin shqiptar, nuk do të garantojë anëtarësimin e Shqipërisë në BE. Kredibiliteti i ligjeve në sytë e publikut humbet nëse ato nuk zbatohen menjëherë pasi ato të aprovohen. Zbatimi i ligjeve duhet të shoqërohet patjetër me faturën e tyre financiare.
- *Nevojitet ndërtimi i kapaciteteve dhe më shumë staf që punon për mjedisin.* Ka mungesa të theksuara në numër dhe cilësi të stafit që punon për mjedisin në Shqipëri. Përveç rritjes së numrit të këtij stafi, duhet që këta nëpunës të kenë kompetenca dhe fuqi ligjore të qarta në mënyrë që të ushtrojnë dhe zbatojnë vendimet. Një agjenci e tipit EPA (Agjencia e Mbrojtjes së Mjedisit në SHBA) mund të ishte një shembull mjaft i mirë për Shqipërinë, nëse do të pajisej me fuqitë e duhura ligjore e financiare.
- *Nevojiten më shumë fonde.* Ngritja e një fondi mjedisor do të shpejtonte dhe lehtësonte procesin, dhe do të vendoste bazat për një bashkëpunim të ardhshëm mes shtetit dhe shoqërisë civile në trajtimin e problemeve mjedisore. Grantet e rezervuara për një synim të caktuar për autoritetet vendore, mund të sjellin shumë ndryshime dhe të stimulojnë inovacionin bashkëpunimin në fushën e mjedisit.
- *Nevojitet bashkëpunim mes qeverisë dhe OJF-ve plus medias.* OJF-të mund të jenë vendimtare për orientimin e politikave të një vendi. Ato kanë staf të aftë, që ndoshta i mungon qeverisë, dhe mund të ofrojnë ekspertizë dhe ndihmë të vlefshme për qeverinë, sidomos në fondet e para-anëtarësimin. Deri tani ky bashkëpunim ka munguar, si pasojë e mungesës së interesit nga ana e qeverive. Media është vendimtare në ndryshimin e qëndrimit të publikut ndaj mjedisit. Një nismë nga media ose nga qeveria në bashkëpunim me median, mund të sjellin ndryshime të mëdha në fushën e mjedisit.
- *Politika favorizuese për biznesin e riciklimit dhe energjive të rinovueshme.* Heqja e taksave doganore dhe tatimeve të tjera, si dhe krijimi i lehtësirave administrative, mund të stimulojë dhe rrisë “bizneset e gjelbra”, duke vendosur kështu bazat për një bashkëpunim të mëtejshëm qeveri-biznes në trajtimin e problemeve mjedisore, duke larguar kështu një barrë financiare të madhe për qeverinë, në zbatimin e direktivave dhe politikave të BE-së rreth mjedisit.



Shtojca 1

Përgjigjet e pyetësorëve sipas moshës dhe arsimimit

Shifrat janë të kthyera në përqindje:

Grupmosha	16 -30	31 - 45	46 - 60	61 - 80	Arsimimi	I lartë	I mesëm	I ulët
Pyetja 1					Pyetja 1			
A	28.5	18	15.5	9.5	A	40.5	26.5	4.5
B	3.5	5.5	3	3.5	B	8.5	7	0
C	6	2	2.5	1	C	5	5.5	1
D	1.5	0	0	0	D	1.5	0	0
A	32.5	20.5	18.5	11	A	45	30.5	5
B	2	3	1.5	0.5	B	4	4.5	0
C	4	2	1	2.5	C	5.5	4	0.5
D	1	0	0	0	D	1	0	0
Pyetja 2					Pyetja 2			
A	28	18	15.5	8.5	A	39	25	4
B	4.5	4.5	4	1.5	B	7	7.5	0.5
C	5.5	3	1	4	C	7.5	6	1
D	1.5	0	0.5	0	D	2	0.5	0
A	31.5	22	20	11.5	A	48	32	4.5
B	2.5	2.5	0.5	0.5	B	3.5	2.5	0
C	5.5	0.5	0.5	1.5	C	4	3.5	1
D	0	0.5	0	0.5	D	0	1	0
Pyetja 3					Pyetja 3			
A	27	14.5	14.5	8	A	36	23	5
B	6.5	6	2.5	2.5	B	8.5	8.5	0.5
C	5	4	3	3	C	8.5	6.5	0
D	1	1	1	0.5	D	2.5	1	0
A	27	17.5	18	8.5	A	41	26.5	4
B	5	4	2	2	B	7	7	0
C	7	3.5	1	2.5	C	7.5	4	1.5
D	0.5	0.5	0	1	D	0	1.5	0
Pyetja 4					Pyetja 4			
A	30	16	14.5	6.5	A	38.5	23	5
B	4	5.5	4	4	B	8.5	9.5	0.5
C	4.5	3	2	3.5	C	7	6	0
D	1	1	0.5	0	D	1.5	0.5	0



A	27	19.5	16.5	9	A	43	25.5	4
B	7	3	3.5	2	B	7.5	8	0
C	5	2.5	0.5	2.5	C	4.5	4.5	1.5
D	0.5	0.5	0.5	0.5	D	0.5	1	0
Pyetja 5					Pyetja 5			
A	25.5	17.5	13.5	8.5	A	36.5	22	5
B	4.5	2	3	2	B	7.5	4.5	0.5
C	8.5	4.5	2.5	3	C	8.5	10.5	0
D	1	1.5	2	0.5	D	3	2	0
Pyetja 6					Pyetja 6			
A	29.5	18.5	18	9.5	A	45.5	25	4
B	4	3	1.5	1	B	2.5	8	0
C	5	3	1	3	C	6	5	1.5
D	1	1	0.5	0.5	D	1.5	1	0
Pyetja 6					Pyetja 6			
A	18.5	13	11.5	6.5	A	27.5	18.5	4
B	9.5	4	5.5	3.5	B	15	7	1
C	9	6.5	2	3.5	C	9.5	10.5	0.5
D	2.5	2	2	0.5	D	3.5	3	0
Pyetja 7					Pyetja 7			
A	21.5	15	16.5	9	A	35	22	4.5
B	7.5	3.5	1.5	3	B	8	8	0.5
C	9.5	7	3	2	C	11.5	9	0.5
D	1	0	0	0	D	1	0	0
Pyetja 7					Pyetja 7			
A	30	17.5	15	8	A	40	26.5	4.5
B	4.5	6.5	3.5	2.5	B	9	8	0.5
C	4.5	1.5	2	3	C	5.5	4	0.5
D	0.5	0	0.5	0.5	D	1	0.5	0
Pyetja 8					Pyetja 8			
A	29.5	21.5	18.5	11	A	45.5	29	5
B	6	1.5	1.5	1	B	5	5.5	0
C	4	2	0.5	1.5	C	4	4	0.5
D	0	0.5	0.5	0.5	D	1	0.5	0
Pyetja 8					Pyetja 8			
i					i			
A	5	4	2	2.5	A	7.5	4	1.5
B	20.5	15.5	10.5	8	B	30	21.5	2.5
C	13	5.5	6.5	2.5	C	15	12	1.5
D	1	0.5	2	1	D	3	1.5	0



ii					ii			
A	5	3.5	2.5	4.5	A	8	4.5	1.5
B	20.5	15.5	12.5	5.5	B	30	22.5	3
C	11	6	5.5	4	C	15	10.5	1
D	3	0.5	0.5	0	D	2.5	1.5	0
iii					iii			
A	3	3.5	2	4	A	6	5	1.5
B	17.5	15	9	4.5	B	22.5	20.5	2
C	14	6	8	4.5	C	23	9.5	2
D	5	1	2	1	D	4	4	0
iv					iv			
A	3	3	1	2.5	A	5.5	2.5	1.5
B	14.5	9.5	8.5	4	B	19	14	3
C	14	10	8	7	C	22.5	15	1
D	8	3	3.5	0.5	D	8.5	7.5	0
v					v			
A	4	4.5	1	2	A	6	3	1.5
B	18.5	9	10.5	8	B	22.5	18	3.5
C	13	10	6	3.5	C	20.5	14.5	0.5
D	4	2	3.5	0.5	D	6.5	3.5	0
vi					vi			
A	8	6.5	1	2.5	A	9	6	1.5
B	18	8.5	11.5	7.5	B	23.5	20.5	3
C	10	7	5.5	3.5	C	17.5	8	1
D	3.5	3.5	3	0.5	D	5.5	4.5	0
vii					vii			
A	3.5	2	1.5	3	A	5.5	4	1.5
B	19	13.5	11	6	B	29.5	18	3
C	15	7	6	3.5	C	16.5	12	1
D	2	3	2.5	1.5	D	4	5	0
Pyetja 9					Pyetja 9			
A	17.5	8.5	10.5	6.5	A	22.5	14	5
B	13	8.5	6.5	3.5	B	17.5	14.5	0.5
C	7	5.5	2	2.5	C	11.5	5.5	0
D	2	3	2	1.5	D	4	5	0
A	34.5	24	20	12.5	A	51	35	5.5
B	2	1	1	1.5	B	3	2.5	0
C	1.5	0.5	0	0	C	1	1	0



D	1.5	0	0	0	D	0.5	0.5	0
Pyetja 10					Pyetja 10			
A	12.5	6.5	9.5	7	A	18.5	12.5	4
B	19.5	12.5	5	4.5	B	27.5	13	0
C	1.5	6.5	0.5	2	C	2.5	2	0.5
D	3	0	5	0.5	D	6.5	8	0.5
E komente	1.5		2	0.5	E komente	2.5	1.5	0.5
Pyetja 11					Pyetja 11			
A	26.5	14	14.5	6.5	A	35.5	22.5	4.5
B	4.5	5.5	4	3	B	7.5	8.5	1
C	6	6	1.5	4	C	10.5	6.5	0
D	2.5	0	1	0.5	D	2	1.5	0
A	30	13.5	17.5	10.5	A	40	26.5	5
B	7	7.5	2	1.5	B	10	8.5	0.5
C	2.5	4.5	1	2	C	5.5	3.5	0
D	0	0	0.5	0	D	0	0.5	0
Pyetja 12					Pyetja 12			
A	2	1.5	0.5	1	A	2	2.5	1
B	9	4.5	6.5	2	B	13.5	7	1
C	25.5	17	12.5	9	C	35	27.5	2
D	1.5	0.5	0	1.5	D	1	1	0.5
E	2.5	0.5	2.5	0	E	4	1.5	0.5
Pyetja 13					Pyetja 13			
A	27.5	14.5	14	5.5	A	32.5	22	4.5
B	10	8	5	5	B	18	11.5	0.5
C	2	1.5	1	0.5	C	2	2	0.5
D	0	1	0	0.5	D	0	1	0
E	1	1	2	0	E	3.5	1	1

Referencat

- CLOSING THE GAP Assessing and Improving Environmental Policy Implementation in Albania. Agenda Institute (2009)
- Bulgaria's Quest to Meet the Environmental Acquis. European Stability Initiative (2008)
- EBRD. Albania Country Strategy (2004)
- European Commission. Stabilisation and Association Report 2008- Albania- COM (2008) final
- EC, Albania Progress Report 2009.
- Commission Staff working Document-Analytical Report accompanying the Communication from the Commission to the European Parliament and the Council: Commission Opinion on Albania's application for membership of the European Union 2010
- Handbook on the implementation of EC Environmental Legislation
- Albanian Ministry of Environment, National Strategy on Environment Sector, October 2007.
- Albanian Ministry of Environment, Inter-sectorial Strategy on Environment 2007
- EC, Handbook for Implementation of EU Environmental Legislation, Draft November 1999.
- Law no 8934 date 05.09.2002 "On the environmental protection"
- Law no 8990 date 23.1.2003 "On the environmental impact assessment"
- Regulation No. 1 date 17. 08. 2004 "On the participation of the public in the environmental impact assessment"
- Law no 9424 date 6/10/2005 on the ratification of Kiev Protocol
- Ministerial order No. 6 date 27.12.2007 "On the preliminary assessment of impacts on the environment a certain activity"
- Law no 9478 date 16/02/2006 "On the ratification of the Espoo convention"
- Law no 9700 date 27/03/2007 on the protection of the environment from transboundary impacts
- Law No. 9424 date 6.10.2005, "On the ratification of the UNECE SEA Protocol", article 2.5
- Draft DCM "On the rules and procedures for the projects with transboundary impact where Albania is the origin party"
- Draft Law "On Strategic Environmental Assessment"
- Ministerial order No. 6 date 27.12.2007 "On the preliminary assessment of impacts of the certain activity"
- Draft Ministerial order "For the list of expenses for the transboundary procedures and methodology
- Draft National methodology on EIA and SEA
- Law no 8672 date 26/10/200 "On the ratification of the Aarhus Convention"
- Law No 8503, date 30.6.1999 "On the public right to access official information"
- Law No. 8475, dated 12. 05.1999 "Code of Administrative Procedures of the Republic of Albania".



DCM “On involvement of the public in Decision making” Air Law no.8897, dt.16.05.2002 “on air protection” New Draft Law “On air protection”
Law no. 9425, dt. 06.10.2005 "On the adherence of the Republic of Albania in the LRTAP Convention"
DCM no.803, dt. Dt. 4.12.2003 “On the air quality norms”
DCM no.103, dt.31.03.02 “On environmental monitoring in the RoA”
Law no.8934, dt. 05.09.2002 “On environmental protection” 18 Waste National Hazardous Waste Management Plan
Law 9010 “On Environmental Treatment of Solid Waste”, date 13/02/2003
Law nr.8934, dated 5.09.2002“On Environmental Protection”
Decision of Council of Minister no 99 of 18.2.2005 – Albanian Catalog of Waste (European Waste Catalogue has been adopted.)
Law no 8990 date 23.1.2003 “On the environmental impact assessment”
Water Law no 8093, date 21.3.1996, “On water reserves”; the new amendment of it
Draft Amendments to law no 8093 “On water reserves”
Decision No. 103 dated 31. 03. 2002 “Concerning environmental monitoring in the Republic of Albania”
Law 9426, date 6/10/2005; “On Livestock breeding”
Law no 8531, date 23/9/1999; “On Fertilizer control service”
Law No.8934, date 5.09.2002 “On environmental protection”
Law no.9115, date 24.7.2003; “Environmental treatment of polluted water”
Law no 9103, date 10.7.2003; “On the protection of transboundary lakes”
DCM no 177, date 31.3.2005, for “Allowed norms of liquid releases and the zoning criteria of receiving water environments” Law nr 8906; date 6.06.2002; “On protected areas”
Law no 8756, date 26.3.2001, “On civil emergencies”
Law no 8905, date 6.6.2002; “On protection of marine environment from pollution and damage”
DCM no. 145, date 26.02.1998 on the Approval of the Hygiene-health regulation on Control of Drinking Water Quality, projection, building and monitoring of drinking water supply systems.
Nature Law no.9219, dated 08.04.2004 “On some changes and additions to the Law no.7875, dated 23.11.1994 “On the protection of wild fauna and hunting””
Regulation no.1, dated 23.2.2005 “On the protection, management of wild fauna and hunting procedures”
Law no.8906, dated 06.06.2002 “On protected areas”
Decision of the Council of Ministers no. 85, dated 21.02.2005 “On the management committees of protected Areas”
Law on Biodiversity Protection No. 9587, dated 20.07.2006
Law on accession to the CITES convention
Law on “Environment Impact Assessment” No 8990, dated 23.1.2003
Regulation no.21, dated 23.02.2005 “On management and protection of wild fauna and development of hunting”
Law on ratification to Bern Convention 19
The law “On the determination of rules and procedures for the international trade in endangered species of wild fauna and flora” dated 31.01.2008
Draft law on biosafety IPC
Law nr.8934, dated 5.09.2002“On Environmental Protection”
DCM no. 249, date24.04.2003, “Concerning the endorsement of applications for



Environmental licenses and information items in the environmental license”
DCM nr.435 dt.12.09.2002 “Concerning Endorsement of discharges in the air in the Republic of Albania
DCM nr.177 date 31.03.2005 for “Allowed norms of liquid releases and the zoning criteria of receiving water environments
Draft Law “On Environmental Protection from Transboundary Effects”
Law no.8756, dated 26.3.2001 “On civil emergencies”
Law no. 8897 dated 16 may 2002” On protection of air from pollution”
DCM nr.579/3, b dated 23.08.2006 “On establishing the Environmental & Forests Agency” (EFA)
Law No. 8457, date 11.2.1999, on “Information classified as state secret”
National Plan for the Approximation of Legislation

Kimikatet

Law no 9108, date 17.7.2003 “On chemical substances and preparations”
DCM no 824 date 11.12.2003 “On Classification, Packaging and Labeling of Hazardous Preparations”
Chemical Weapons Convention
Convention on Access to Information, Public Participation in Decision-Making and Access to Justice in Environmental Matters
http://europa.eu/pol/env/index_en.htm
<http://albania.rec.org/Projects/Ligjet/Konventa%201.html>

Konventa per mbrojtjen e mjedisit detar dhe zones bregdetare te detit mesdhe
Konventa per ruajtjen e flores dhe faunes se eger dhe mjedisit natyror te Evropes
Konventa per mbrojtjen e specieve shtegtuese te kafsheve te egra
Konventa mbi ndotjen atmosferike ne distanca te medha
Konventa per vleresimin e ndikimit ne mjedis ne kontekstin nderkufitar
Konvente e bazelit mbi kontrollin e levizjeve nderkufitare te mbetjeve te rrezikshme dhe asgjesimin e tyre pershtatur nga konferenca e plenipoteniarene ne 22 mars 1989
Konventa per tregtine nderkombetare te specieve te rrezikuara te flores dhe faunes se eger (CITES)
Konventa per te drejten e publikut per informacion, pjesemarrje ne vendim marrje dhe te drejten per t`ju drejtuar gjykates, per ceshtje qe lidhen me mjedisin
Konventa e kombeve te bashkuara per te luftuar shkretetirezimin ne ato vende qe kane kaluar thatesire serioze dhe/ose shkretetirezim, veçanerisht ne Afrike.

Directive 2003/4/EC of the European Parliament and of the Council of 28 January 2003 on **public access to environmental information** and repealing Council Directive 90/313/EEC
Guidance document for member States' reporting under Article 9 of Directive 2003/4
Directive 2003/35/EC of the European Parliament and of the Council of 26 May 2003 providing for **public participation** in respect of the drawing up of certain plans and programmes relating to the environment and amending with regard to public participation and access to justice Council Directives 85/337/EEC and 96/61/EC

Strategy and Action Plan for Implementation of Aarhus Convention in Albania. Ministry of Environment. 2005.

Dabelko, G.D. 1996. "Ideas and the Evolution of Environmental Security Conceptions." Paper presented at the International Studies Association Annual Meeting, San Diego, CA, April 1996.

Kobtzeff, Oleg. 2000. "Environmental Security and Civil Society", in- Gardner, Hall, (ed.) Central and South-central Europe in Transition, Westport, Connecticut: Praeger, 2000, pp. 219-296.

Dodds, F. Pippard, T. 2005. (edited) "Human and Environmental Security: An Agenda for Change, London. Earthscan.

Dodds, F. Higham, A. Sherman, R. 2009. (edited) "Climate Change and Energy Insecurity: The Challenge for Peace, Security and Development", London. Earthscan

Barry Buzan, Ole Waever, and Jaap de Wilde, *Security: A New Framework for Analysis* (Boulder: Lynne Rienner Publishers, 1998).